



Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

## REPUBLIKA E SHQIPËRISË ZGJEDHJET PARLAMENTARE

24 qershor – 19 gusht 2001

“Ky përkthim në shqip është përgatitur vetëm për qëllime konsultimi.  
Raporti i vetëm zyrtar i ODIHR-it është teksti i bashkëngjitur në anglisht”



Varshavë  
11 tetor 2001

## PASQYRA E LËNDËS

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	<b>1</b>
<b>II. HYRJE DHE VLERËSIME</b> .....	<b>3</b>
<b>III. HISTORIKU</b> .....	<b>4</b>
<b>IV. KUADRI LIGJOR</b> .....	<b>4</b>
<b>V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE</b> .....	<b>5</b>
A. STRUKTURA DHE PËRBËRJA E ADMINISTRATËS SË ZGJEDHJEVE .....	5
B. PUNA E KRYER NGA ADMINISTRATA ZGJEDHORE.....	6
1. <i>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve</i> .....	6
2. <i>Komisionet Zonale Zgjedhore</i> .....	7
3. <i>Veprimtaria e KQZ-së pas Raundit të Parë</i> .....	7
C. REGJISTRIMI I PARTIVE, KANDIDATËVE, DHE LISTAT SHUMËMËRORE .....	8
D. REGJISTRI I VOTUESVE.....	9
<b>VI. PJESËMARRJA E GRAVE NË PROCESIN ZGJEDHOR</b> .....	<b>10</b>
<b>VII. FUSHATA</b> .....	<b>11</b>
<b>VIII. MEDIA</b> .....	<b>12</b>
A. PANORAMA E MEDIAS.....	12
B. RREGULLAT E MEDIAS.....	12
C. MONITORIMI I MEDIAS.....	12
<b>IX. VËZHGESIT VENDAS</b> .....	<b>14</b>
<b>X. VËZHGIMI I VOTIMIT, NUMËRIMIT DHE PASQYRIMIT TË REZULTATEVE</b> .....	<b>14</b>
A. VOTIMI.....	14
B. NUMËRIMI.....	16
C. PASQYRIMI I REZULTATEVE TË ZGJEDHJEVE .....	16
D. PËRSËRITJA E ZGJEDHJEVE PËR VOTIMIN PROPORCIONAL.....	17
E. RINUMËRIMI .....	19
<b>XI. ZHVILLIMET PAS 22 KORRIKUT ME PËRFUNDIMIN E MVZ</b> .....	<b>19</b>
<b>XII. ANKESAT DHE APELIMET</b> .....	<b>20</b>
A. TRAJTIMI NGA KQZ-JA I ANKESAVE DHE APELIMEVE PASZGJEDHORE.....	20
B. TRAJTIMI I NGA GJYKATAT I ANKESAVE DHE APELIMEVE PASZGJEDHORE.....	20
<b>XIII. REZULTATET</b> .....	<b>21</b>
<b>XIV. REKOMANDIME</b> .....	<b>22</b>
A. KUADRI LIGJOR .....	22
B. ADMINISTRATA ZGJEDHORE .....	23
C. MEDIA DHE FUSHATA .....	24
D. PJESËMARRJA E GRAVE NË PROCESIN ZGJEDHOR .....	24

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ZGJEDHJET PARLAMENTARE**  
**24 qershor – 19 gusht 2001**

**Raporti Përfundimtar i OSBE/ODIHR-it<sup>1</sup>**  
**11 tetor 2001**

**I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 në Shqipëri shënuan përparim në krahasim me zgjedhjet e kaluara përse i përket zhvillimit të fushatës, medias dhe administrimit të zgjedhjeve. Ndonëse rezultati i 24 qershorit tregoi se Partia Socialiste (PS) në pushtet do të arrinte të formonte një qeveri, ajo që kërkohet nga udhëheqja e partisë ishte një vullnet më i madh politik, në mënyrë që zgjedhjet të përmbushnin plotësisht standartet ndërkombëtare. Një zhvillim i mirëpritur dhe, ndryshe nga zgjedhjet e mëparshme, ishte se partitë politike kërkuan zgjidhje në rrugë ligjore për ankesat e tyre. Megjithatë, proceset administrative dhe juridike nuk ofruan gjithmonë mjete efikase zgjidhjeje.

Që nga përmbysja e komunizmit, janë zhvilluar katër herë zgjedhje të përgjithshme në Shqipëri. Zgjedhjet e 29 qershorit 1997 pasuan trazirat e rënda në vend. Këto zgjedhje u karakterizuan nga një kulturë politike e polarizuar me antagonizma të thella ndërmjet forcave politike të grupuara rreth Partive kryesore Socialiste dhe Demokratike, dhe fatet e tyre ndryshonin në mënyrë dramatike nga njëra zgjedhje në tjetrën. Kuvendi i mëparshëm dominohej fuqimisht nga Partia Socialiste. Në vitin 2000, Kuvendi miratoi një Kod të ri Zgjedhor, i cili shënoi përparim të qenësishëm në krahasim me ligjin e mëparshëm.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 krijuan mundësinë për një konsolidim të mëtejshëm të standarteve demokratike, pas zgjedhjeve të pushtetit vendor që u zhvilluan në tetor të vitit 2000 dhe që shënuan një përparim domethënës në drejtim të plotësisht të standarteve për zgjedhje demokratike. Përveçse përcaktuan qeverinë e ardhshme, zgjedhjet parlamentare ishin gjithashtu thelbësore për zgjedhjen e Presidentit në vitin 2002, sepse kandidatit fitues do t'i duhen votat e të paktën 84 prej të 140 deputetëve.

Një sërë elementësh pozitivë karakterizuan procesin e zgjedhjeve parlamentare në krahasim me zgjedhjet e mëparshme, veçanërisht deri në raundin e parë të votimit më 24 qershor, duke përfshirë:

- në përgjithësi, dega ekzekutive e qeverisë shmangu ndërhyrjen në proces;
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) funksionoi me një pavarësi dhe transparencë më të madhe;
- një spektër i gjerë i mediave përcolli informacion të shumëllojshëm politik për elektoratin;
- përpara raundit të parë, stacioni publik (TVSH) ndau kohën ndërmjet konkurrentëve kryesorë në mënyrë të drejtë;
- fushata zgjedhore u zhvillua në një atmosferë të qetë, me përjashtim të incidenteve të izoluara, dhe, në pjesën më të madhe, retorika e fushatës ishte e përmbajtur; dhe
- votimi ishte mjaft i qetë dhe i rregullt;

Megjithatë, procesi zgjedhor ishte i tejzgjatur, konfliktual, i pasigurtë dhe i fragmentuar. U deshën pesë raunde votimesh më 24 qershor, 8 korrik, 22 korrik, 29 korrik dhe 19 gusht për të përfunduar procesin. Në secilin raund, numri i fushave të kontestuara u kufizua, por problemet aty u bënë edhe

---

<sup>1</sup> Ky raport është gjithashtu i disponueshëm në shqip. Megjithatë, teksti anglisht mbetet i vetmi tekst zyrtar.

më serioze. Në shumë zona, zgjedhjet u përsëritën në disa qendra votimi, dhe në disa raste më shumë se një herë.

Shqetësimet më specifike përfshijnë:

- parregullsi serioze në procesin zgjedhor, përfshirë këtu raste të mbushjes së kutive të votimit dhe të përdorimit të fletëve të votimit të parashenuara, u vërejtën në një numër të kufizuar zonash dhe në një numër të vogël zonash ku kandidonin politikanë të sprovuar, pasqyrimi i rezultateve ishte problematik, duke minuar kështu progresin e arritur dhe duke i bërë disa parti politike të vinin në dyshim rezultatet në ato zona;
- me çështjen e kandidatëve të pavarur, PS-ja vuri në provë ligjin, duke kapërcyer çdo kufi të pranueshëm dhe, më vonë, ajo e shfrytëzoi vonesën e zgjedhjeve të proporcionalit në Zonën 60, që u shkaktua për arsye të mosshpërndarjes së materialeve zgjedhore në prag të raundit të parë të zgjedhjeve;
- trysnia politike në disa raste dukej sikur kompromentonte veprimtarinë e KQZ-së;
- pasqyrimi nga transmetuesi publik (TVSH) u përkeqësua pas raundit të parë, duke favorizuar partinë qeverisëse;
- pati raste të ndërhyrjes policore në procesin zgjedhor; (shih kapitullin X të këtij raporti);
- mënyra me të cilën KQZ-ja trajtoi disa prej ankesave zgjedhore kyçe nuk ishte gjithmonë e mjaftueshme; (shih kapitullin X dhe XII të këtij raporti)
- Gjykata Kushtetuese, dhe në disa raste gjykatat e tjera nuk i zbatuan standartet në mënyrë të vazhdueshme, duke u treguar paksa të njëanshëm në favor të partisë në pushtet. (shih kapitullin X dhe XII të këtij raporti); dhe
- partitë kryesore politike vazhduan ta trajtonin njëra-tjetrën më tepër si armike sesa si kundërshtarë politike të ligjshme.

Megjithë këto shqetësime, nuk ishte fitorja e PS-së në këto zgjedhje që u vu në dyshim, por vetëm gjerësia e kësaj fitoreje.

Megjithëse vlerësimi fillestar ishte më pozitiv pas raundit të parë të votimit, procesi zgjedhor i tejzgjatur, si edhe shkeljet e përsëritura dhe gjithnjë e më serioze në raundet e tjera të zgjedhjeve, veçanërisht në Zonën 60, bindën OSBE/ODIHR-in për nevojën e modifikimit të vlerësimit të saj për këto zgjedhje në tërësi. Menjëherë pas përfundimit të procesit, opozita i paraqiti prova të qënësishme rreth këtyre shkeljeve OSBE/ODIHR-it. Në vijim të kësaj OSBE/ODIHR-i kërkoi interpretimin e autoriteteve mbi shkeljet e pretenduara. Autoritetet u përgjigjën menjëherë duke paraqitur prova shtesë më 28 shtator. Shqyrtimi nga OSBE/ODIHR-i i të gjitha provave të paraqitura çoi në vonesën e publikimit të këtij raporti përfundimtar.

Duke patur parasysh sa më lart, OSBE/ODIHR-i rekomandon si vijon:

- mjete të përshtatshme, për shembull, ngritja e një komisioni parlamentar bipartizan për të shqyrtuar shqetësimet rreth këtyre zgjedhjeve me qëllim, propozimin e zgjidhjeve për të ardhmen;
- megjithëse Kodi Zgjedhor përbën një bazë për zgjedhje demokratike, sfidat që u përshkruan me hollësi këtu propozojnë rishikimin e Kodit në një sërë fushash kyçe, të detajuara në mënyrë më të plotë në rekomandimet e këtij raporti;
- procesi i ankesave dhe apelimeve zgjedhore kërkon një vëmendje të veçantë; dhe
- duhet të përmirësohet saktësia e Listës së Votuesve.

OSBE/ODIHR-i, në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, është i gatshëm të punojë ngushtë me autoritetet dhe shoqërinë civile të Shqipërisë për të trajtuar shqetësimet dhe rekomandimet e këtij raporti.

## II. HYRJJE DHE VLERËSIME

Në përputhje me angazhimet e saj si një shtet anëtar i OSBE-së, qeveria e Republikës së Shqipërisë ftoi Zyrën e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) për të vëzhguar zgjedhjet parlamentare të 24 qershorit.

Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it (MVZ) u vendos në Tiranë më 22 maj, me Nikolai Vulchanov si Kryetar i Misionit, dhe menjëherë pas kësaj filloi vëzhgimin e procesit zgjedhor me 10 ekspertë të vendosur në shtabin drejtues në Tiranë, si dhe 18 vëzhgues afatgjatë të vendosur në qarqe.

Për raundin e parë të votimeve më 24 qershor, MVZ-së iu bashkuan Asambleja Parlamentare e OSBE-së (AP), Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE), dhe Parlamenti Evropian (PE) për të formuar Misionin Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MNVZ). Rreth 250 vëzhgues afatshkurtër u shpërndanë nga 30 shtete anëtare të OSBE-së, duke përfshirë 39 nga AP e OSBE-së, 17 nga APKE-ja dhe 7 nga PE-ja. Gjithashtu, *Organisation Internationale de la Francophonie (Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë)* kontribuoi me 14 vëzhgues për MNVZ-në për ditën e zgjedhjeve.

Z. Bruce George, Deputet (UK), Nënpresidenti i AP-së së OSBE-së, u zgjodh nga Kryetari i Rradhës së OSBE-së si Koordinator Special për zgjedhjet në Shqipëri në krye të vëzhguesve afatshkurtër të OSBE-së. Z. Jerzy Smorawinski, Deputet (Poloni) kryesoi delegacionin e APKE-së, dhe Znj. Doris Pack, Deputete (Gjermani) kryesoi delegacionin e PE-së.

Më 24 qershor, MNVZ-ja vëzhgoi votimin në mbi 1000 prej 4578 qendrave të votimit në Shqipëri. Për raundin e dytë të votimit më 8 korrik, dhe më 22 korrik, MNVZ-ja përbëhej nga OSBE/ODIHR-i dhe APKE-ja. Më 8 korrik, personelit ekzistues prej 28 personash të OSBE/ODIHR-it në Shqipëri, iu shtuan rreth 130 vëzhgues afatshkurtër, duke përfshirë 8 deputetë të APKE-së, të cilët u shpërndanë në të gjithë Shqipërinë. Më 22 korrik, rreth 48 vëzhgues afatshkurtër, përfshirë këtu pesë deputetë të APKE-së, u shpërndanë nëpër të gjithë zonat ku u zhvilluan zgjedhje.

Pas largimit të MVZ-së nga Shqipëria më 23 korrik, vëzhgimi i votimit më 29 korrik u bashkërendua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, e cila shpërndau tetëmbëdhjetë vëzhgues. Për votimin e 19 gushtit, Prezenca e OSBE-së shpërndau dy ekipe vëzhguesish në Zonën 82, konkurrimi i vetëm zgjedhor i pazgjidhur. Në shtator, ODIHR-i u kthye në Tiranë për një sërë konsultimesh me partitë politike, autoritetet shqiptare, shoqërinë civile dhe komunitetin ndërkombëtar. Përveç kësaj, delegacione nga opozita dhe autoritetet vizituan OSBE/ODIHR-in gjatë javës së tretë dhe të katërt të shtatorit, të cilët dorëzuan dokumentacion plotësues për çështje të ndryshme shqetësuese.

OSBE/ODIHR-i dëshiron të falënderojë Ambasadorin Geert-Hinrich Ahrens dhe Prezencën e OSBE-së në Shqipëri për mbështetjen e tyre gjatë gjithë kohëqëndrimit të misionit, si dhe ambasadat dhe organizatat ndërkombëtare për mbështetjen e tyre në ditët e votimit. OSBE/ODIHR-i i shpreh gjithashtu mirënjohjen Misionit të OSBE-së në Bosnjë dhe Hercegovinë për vëzhguesit afatshkurtër të sponsorizuar në datat 8 dhe 22 korrik.

OSBE/ODIHR-i dëshiron t'u shprehë vlerësimin e tij autoriteteve shqiptare, veçanërisht KQZ-së, Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ), dhe Zyrës së Kryeministrit, për asistencën dhe bashkëpunimin në kohë të tyre gjatë misionit të vëzhgimit si edhe gjatë punës vijuese nga Varshava.

### III. HISTORIKU

Më 18 prill 2001, Presidenti i Republikës shpalli mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare më 24 qershor 2001.<sup>2</sup> Periudha që nga zgjedhjet e fundit parlamentare në qershor 1997, vuri në dukje një stabilizim të qëndrueshëm të vendit, i arritur me mbështetjen aktive të komunitetit ndërkombëtar, i cili pati një bashkëpunim të mirë me autoritetet.

Një tipar i rëndësishëm i zgjedhjeve parlamentare të vitit 2001 ishte vendimi i PS-së, e udhëhequr nga Fatos Nano, për t'u shkëputur nga partnerët e saj të përfshirë në koalicionin e kaluar qeverisës "Aleanca për Shtetin" dhe për të hyrë në zgjedhje e vetme. Pra, Partia Social Demokrate (PSD), Partia e Bashkimit të Drejtave të Njeriut (PBDNJ), Partia Agrare (PA), dhe Partia e Aleancës Demokratike (PAD) u gjendën pa një aleat të rëndësishëm politik dhe u përballën me mundësinë e humbjes së vendeve të tyre në Kuvend, si edhe posteve të tyre qeveritare. Partia Demokratike (PD), e udhëhequr nga ish-Presidenti i Republikës, Sali Berisha, krijoi një aleancë zgjedhore me një numër partish të vogla dhe zhvilloi fushatën si "Bashkimi për Fitoren"(BF).<sup>3</sup> Duke pasuar një ndarje të PD-së, në fillim të vitit 2001 disa Deputetë të PD-së krijuan një "Parti Demokratike" të re, e cila hyri në zgjedhje nën udhëheqjen e Genc Pollos si një alternativë ndaj PS-së dhe PD-së.

### IV. KUADRI LIGJOR

Zgjedhjet parlamentare u zhvilluan nën një Kod Zgjedhor të aprovuar nga Kuvendi në maj të vitit 2000, dhe të ndryshuar në maj të vitit 2001.<sup>4</sup> Ndonëse Kodi Zgjedhor ofron bazën për zgjedhje demokratike, sfidat e provuara gjatë zgjedhjeve të vitit 2001 dhe vonesa në përcaktimin e përbërjes përfundimtare të Kuvendit tregojnë se ai mund të përmirësohet në një numër drejtimesh. Këto përfshijnë qartësimin e kompetencave përkatëse të komisioneve zgjedhore dhe gjykatave, qartësimin e afateve për gjykimin e ankesave dhe të apeliimeve, dhe përcaktimin e procedurave të qarta të paraqitjes, marrjes në konsideratë dhe gjykimin të ankesave dhe apeliimeve. Veçanërisht, kompetencat e KQZ-së duhet të qartësohen dhe të përvijohen në Kod, meqenëse KQZ-ja nuk arriti të ushtronte plotësisht kompetencat e saj në një sërë rastesh kritike mosmarrëveshjesh.

---

<sup>2</sup> Presidenti zgjidhet nga Kuvendi për një mandat pesëvjeçar dhe kërkon votat e të paktën 84 prej 140 anëtarëve të Kuvendit. Pas pesë përpjekjesh rradhazi për të zgjedhur Presidentin në Kuvend, në rast dështimi, duhet të zhvillohen zgjedhje të reja parlamentare.

<sup>3</sup> Ato ishin Partia Demokratike, Partia Republikane, Partia e Ballit Kombëtar, Partia e Lëvizjes së Legalitetit, dhe Bashkimi Liberal.

<sup>4</sup> Ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë ndihmuan autoritetet shqiptare në hartimin e Kodit Zgjedhor. Në vijim të diskutimeve në tryezat e rumbullakta shumëpartiake që përfshinë përfaqësues të KE-së, Fondacionit Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES), Agjencisë për Zhvillimin Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID), dhe OSBE-së, Kuvendi miratoi Kodin Zgjedhor më 8 maj 2001, duke përfshirë në të amendamentet e minutës së fundit të paraqitura nga mazhoranca parlamentare e udhëhequr nga PS-ja. Përbërja e KQZ-së, e përcaktuar në Kushtetutë, si edhe caktimi i parakohshëm i gjashtë anëtarëve të KQZ-së përpara miratimit të Kodit Zgjedhor, e çoi PD-në në mohimin e Kodit në tërësi dhe në bojkotimin e miratimit të tij në Kuvend, edhe pse ajo kishte marrë pjesë në shumicën e diskutimeve të tryezave të rumbullakta.

Kushtetuta përcakton një sistem specifik “të përzier” zgjedhor, me komponentë të ndërvarur mazhoritar dhe proporcional, që kërkon zgjedhjen e 100 deputetëve në zonat njëemërore dhe të 40 deputetëve nga një zonë zgjedhore mbarëkombëtare mbi bazën e listave partiake apo të koalicioneve. Një raund i dytë votimi në zonat njëemërore është i nevojshëm, në rast se, asnjë nga kandidatë nuk arrin një mazhorancë absolute.

Partitë duhet të marrin të paktën 2,5%, dhe koalicionet 4% të votave të vlefshme në shkallë kombëtare për të marrë pjesë në ndarjen e 40 mandateve plotësuese. Neni 64 i Kushtetutës kërkon që “numri i përgjithshëm i deputetëve të çdo partie dhe/ose koalicioni partish përcaktohet në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve...” Neni 66 i Kodit Zgjedhor përcakton një formulë, e cila përpiket të ndajë të 40 mandatet plotësuese në një mënyrë të tillë që “të kompensojë” partitë, të cilat kanë siguruar një pjesë të votave në shkallë vendi, por që nuk arritën të fitonin një numër të mjaftueshëm zonash njëemërore për të pasqyruar mbështetjen e tyre zgjedhore.

Megjithatë, neni 66 mund të anashkalohej, duke qenë se Kodi Zgjedhor ofron mundësinë e përdorimit të dy votave, një për zonën njëemërore ku banon votuesi, dhe një për listat partiake në shkallë vendi. Në qoftë se një kandidat që përfaqëson *de facto* një parti politike, regjistrohet *de jure* si një kandidat “i pavarur”, atëherë formula e ndarjes mund të anashkalohej në rast se zgjedhësi hedh votën e tij të parë në favor të kandidatit “të pavarur” dhe votën e tij të dytë për partinë politike që “mbështet” kandidatin “e pavarur”, sepse ky mandat nuk konsiderohet të jetë i fituar nga ajo parti politike që mbështeti kandidatin “e pavarur”. Në këtë mënyrë, partia politike është në gjendje të “fryjë” pjesën e saj të 40 mandateve plotësuese në shkallë vendi. Ndarja e mandateve plotësuese dhe shfrytëzimi i pseudokandidatëve “të pavarur” u bënë çështjet më të debatuar në periudhën e fushatës zgjedhore.

## V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

### A. STRUKTURA DHE PËRBËRJA E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE

Kodi Zgjedhor ofron një strukturë administrative me katër nivele që përbëhet nga KQZ-ja, 100 Komsione Zgjedhore Zonale (KZZ-të), 385 Komisione Zgjedhore të Qeverisjes Vendore (KZQV-të) dhe Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV-të), të cilat ishin afërsisht 4700 për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001.

Kushtetuta përcakton KQZ-në si një organ shtetëror të përhershëm që përbëhet nga 7 anëtarë me të drejtë vote, me një mandat shtatëvjeçar. Pas konsultimeve, Presidenti i Republikës cakton dy anëtarë, Kuvendi cakton dy anëtarë, dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë cakton tre anëtarë. Çdo parti politike dhe koalicion i regjistruar në KQZ mund të caktojë një përfaqësues pa të drejtë vote pranë KQZ-së.

Për arsye të dorëheqjeve, u caktuan tre anëtarë të rinj në KQZ në shkurt të vitit 2001, dhe Ilirjan Celibashi u zgjodh Kryetar. Ai është një ish-gjyqtar, dhe ka punuar gjithashtu për dy muaj në postin e Zëvendës Ministrit të Rendit Publik.

Sipas nenit 158 të Kodit Zgjedhor (një dispozitë kalimtare), KZZ-të dhe KQV-të përbëhen nga një Kryetar, një Zëvendëskryetar, dhe pesë anëtarë të caktuar nga KQZ-ja dhe KZZ-të përkatësisht nga të shtatë partitë politike që fituan më shumë vota në shkallë vendi në zgjedhjet parlamentare të vitit

1997.<sup>5</sup> KQZ-ja emëron Kryetarin dhe Zëvendës Kryetarin e KZZ-së në bazë të propozimeve të bëra nga KZZ-ja. Megjithatë, vetëm dy partitë që morën më shumë vota në zgjedhjet parlamentare të vitit 1997, PS-ja dhe PD-ja, u lejuan të paraqisnin propozime. Çdo KZZ dhe KQV cakton një sekretar pa të drejtë vote. Partitë dhe kandidatët mund të caktojnë përfaqësues pa të drejtë vote pranë këtyre organeve. Ligji i detyron KZZ-të të sigurojnë administrimin e koherent të zgjedhjeve në zonën e tyre njëmërore. Për zgjedhjet parlamentare, roli i KZQV-ve u kufizua në plotësimin e të dhënave dhe rishikimin e listave paraprake të votuesve.

## **B. PUNA E KRYER NGA ADMINISTRATA ZGJEDHORE**

### **1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

Në përgjithësi, ndryshe nga zgjedhjet e mëparshme, KQZ-ja tregoi një pavarësi dhe transparencë më të madhe në vendimmarrje. Në krahasim me zgjedhjet e mëparshme, organizimi prej saj i procesit zgjedhor shënoi përmirësim dhe u zbatuan disa nga rekomandimet e përfshira në Raportin Përfundimtar të OSBE/ODIHR-it për Zgjedhjet e Qeverisjes Vendore 2000.<sup>6</sup>

Partitë politike përfituan nga e drejta e tyre për të paraqitur qëndrimet gjatë seancave të KQZ-së dhe në disa raste pikëpamjet e tyre u morën parasysh. Megjithatë, mënyra se si KQZ-ja trajtoi ankesat kryesore zgjedhore nuk ishte gjithmonë e mjaftueshme. Si pasojë, partitë dhe kandidatët kërkuan zgjidhje tek gjykatat. Trysnia politike e ushtruar nga udhëheqja e PS-së, në disa raste, dukej sikur e kompromentonte veprimtarinë e KQZ-së.

Kryetari i KQZ-së kërkoi një qëndrim kolegjal ndaj vendimmarrjes, e cila ishte vetëm pjesërisht e sukseshme. KQZ-ja ishte e përcarë për shumë çështje të rëndësishme dhe disa vendime u morën me votën e shumicës, duke mposhtur një opinion mjaft të fortë të pakicës. Kjo u duk mjaft qartë gjatë diskutimeve për regjistrimin e kandidatëve “të pavarur” që mbështeteshin nga një parti, ankesat dhe apelimet paszgjedhore, dhe për votimin e vonuar në Zonën 60.

KQZ-ja u tregua aktive, mblidhej rregullisht dhe miratoi rreth 47 udhëzime dhe një numër të madh vendimesh. Megjithatë, axhendat e seancave dhe dokumentat përkatëse, shpesh, nuk shpërndareshin përpara takimeve dhe u morën disa vendime të rëndësishme në takime jozyrtare. Si pasojë, disa përfaqësues partiakë nuk kishin dijeni për temat e diskutimit dhe nuk ishin të informuar për të gjitha vendimet e marra. KQZ-ja nuk zbatoi gjithmonë rregulla korrekte procedurale në dhënien e vendimeve. Përpara raundit të parë, çështja e kandidatëve të pavarur dhe caktimi i anëtarëve të KZZ-ve mbizotëroi në axhendat e takimeve të KQZ-së, duke lënë një kohë të pamjaftueshme për të trajtuar çështje të rëndësishme teknike.

Duke përfaqësuar një qëndrim kolegjal, KQZ-ja u përpoq të caktojë Sekretarët e KZZ-ve më tepër sipas kualifikimeve profesionale dhe reputacionit të tyre, se sa përkatësisë politike. Ky qëndrim erdhi pas shqetësimit lidhur me “keqpërdorimin” e vulës zyrtare të KZZ-së, e cila përdorej për t’iu dhënë vlefshmërinë të gjitha dokumenteve zyrtare duke përfshirë edhe rezultatet. KQZ-ja ishte vetëm pjesërisht e sukseshme në zbatimin e strategjisë së vet, sepse, në shumë raste, partitë kryesore politike vendosën në këto pozicione të rëndësishme njerëzit e tyre të besuar partiakë. Disa herë,

<sup>5</sup> Këto ishin Partia Socialiste, Partia Demokratike, Partia Lëvizja e Legalitetit, Partia Republikane, Partia Social Demokrate, Partia e Bashkimit të Drejtave të Njeriut, dhe Partia Aleanca Demokratike.

<sup>6</sup> Për shembull, përpara zgjedhjeve, u miratuan “Rregullat e Procedurës” dhe u riorganizuan departamentet administrative. Pati më tepër KZZ dhe KQV që u trajnuan dhe u shpërndanë materiale reference për pothuajse të gjitha KZZ-të dhe KQV-të. Më tepër vëmendje ju kushtua përhapjes së informacionit publik nëpërmjet spoteve televizive, njoftimeve për shtyp dhe intervistave për median.



grindjet midis partive në lidhje me këto emërimë ishin kaq të thella, saqë ishte e pamundur të arrihej një marrëveshje. Si pasojë, disa nga sekretarët e KZZ-ve u emëruan shumë më vonë pas regjistrimit të kandidatëve, dhe për më tepër, disa prej tyre u emëruan edhe në prag të raundit të parë.

Vendimet mbi emërimin e Kryetarëve të KZZ-ve provokuan shpesh ndërhyrje polemike nga përfaqësuesit partiakë gjatë seancave të KQZ-së. Emërimet u konsideruan nga të dyja partitë kryesore si një “lojë e shumës-zero” dhe për pasojë PS-ja dhe PD-ja luftuan fuqimisht për të përforcuar pozitat e tyre në maksimum. Grindjet ndërpartiake, si në nivele vendore ashtu dhe kombëtare, çuan në emërimet e vonuara të shumë prej anëtarëve të KZZ-ve, duke shkaktuar probleme organizative. Megjithëse me vonesë, të 100 Kryetarët e KZZ-ve u emëruan me një ekuilibër të përgjithshëm politik në zona.<sup>7</sup>

KQZ-ja dhe MVZ-ja morën shumë ankesa nga partitë dhe KZZ-të për anëtarët dhe sekretarët që nuk plotësonin kriteret ligjore për anëtarësim.<sup>8</sup> KQZ-ja e pa të pamundur të verifikonte secilin rast dhe më në fund, Komisioni vendosi se partitë ishin të detyruara të paraqisnin dokumentacion të plotë në mbështetje të argumentave të tyre ose të apelonin vendimet e KQZ-së në gjykata.

## 2. Komisionet Zonale Zgjedhore

Megjithëse pjesa më e madhe e KZZ-ve funksionoi mirë, profesionalizmi i shumë prej tyre u vu në pikëpyetje dhe vendimet u ndikuan nga rivalitete të fuqishme politike në ato çka duhet të ishin institucione politikisht të paanshme. Në disa zona, sjellja e anëtarëve të KZZ-ve të emëruar nga partitë ishte në mënyrë të papranueshme e njëanshme, në disa raste duke penguar procesin deri në aty sa zgjedhjet nuk u zhvilluan siç ishte planifikuar.

Vëzhguesit e zgjedhjeve njoftuan se shumë prej KZZ –ve dukeshin të paorganizuara, të keqpajisura dhe të papërgatitura. KZZ-të u ankuan se infrastruktura dhe mjetet e komunikimit të vëna në dispozicion nga autoritetet vendore ishin të një niveli të ulët. Komunikimi midis KQZ-së dhe KZZ-ve kalonte shpesh nëpërmjet organeve të qeverisjes vendore, gjë e cila dobësonte fshehtësinë e të dhënave dhe krijonte mundësinë e ushtrimit të një ndikimi të padrejtë mbi KZZ-të. Pas ndryshimeve në kufijtë e zonave zgjedhore në fillim të vitit 2001, disa prej KZZ-ve ishin të paqarta lidhur me përbërjen e saktë territoriale të zonave të tyre. Kjo krijoi pështjellim lidhur me krijimin e qendrave të votimit, emërimin e KQV-ve, dhe korrigjimin e shpalljen e listave të votuesve.

Komisionet zgjedhore nuk arritën të respektojnë disa afate të caktuara ligjore dhe KQZ-ja nuk arriti të miratonte në kohë listat përfundimtare të votuesve, duke shkaktuar vonesa në shpërndarjen e tyre tek KZZ-të. Shumë prej KQV-ve u emëruan nga KZZ-të tepër vonë në këtë proces, në disa raste, vetëm pak ditë para raundit të parë. Këto mangësi thelluan vonesat ekzistuese, në një kalendar zgjedhor tashmë tepër të ngjeshur. Përveç këtyre, interpretimet e ndryshme të vendimeve dhe udhëzimeve të KQZ-së nga ana e KZZ-ve çuan në një mungesë të njëtrajtshmërisë në zbatimin e dispozitave ligjore në të 100 zonat.

## 3. Veprimtaria e KQZ-së pas Raundit të Parë

<sup>7</sup> BF-ja siguroi pozitat e 45 Kryetarëve dhe PS-ja 55.

<sup>8</sup> Përfshirë në nenin 32 të Kodit Zgjedhor. Një akuzë e përbashkët ishte se një anëtar i KZZ-së nuk kishte arsimin e lartë. Një akuzë tjetër ishte se sekretari i KZZ-së nuk ishte jurist. Gjithashtu, pati ankesa se disa individë nuk mund të kualifikoheshin për arsye të çështjeve të lidhura me dënime penale, vendbanimin, dhe mbajtjes së posteve në qeverisjen vendore.

Pas raundit të parë, shumë seanca të KQZ-së u mbizotëruan nga vendime për rezultatet e zgjedhjeve dhe gjykimin e ankesave. Megjithatë, u diskutuan çështje të tjera të rëndësishme dhe u miratuan disa udhëzime domethënëse. Deri më 22 korrik, KQZ-ja shkarkoi mbi 40 anëtarë KZZ-sh në 12 zona, si edhe një numër anëtarësh të KQV-ve, për arsye se penguan procesin dhe, ose nuk arritën të zhvillonin procesin zgjedhor dhe dështuan në mbajtjen e zgjedhjeve e në parandalimin e parregullsive serioze, ose nuk arritën të plotësonin në mënyrë të rregullt procesverbalet e rezultateve. Disa anëtarë komisionesh u gjobitën dhe të tjerë u çuan për ndjekje penale.

Pas konkluzionit të KQZ-së dhe gjykatës se raundi i parë dhe i dytë pati parregullsi, përsëritja e votimit në disa zona solli probleme organizative për administratën zgjedhore. Vendimet në lidhje me planifikimin e zgjedhjeve dhe me kohën e nevojshme për gjykimin e rasteve krijuan pasiguri përsa i përket faktit se cilat prej zonave do të kishin zgjedhje të mëtejshme dhe një “fragmentim” të procesit zgjedhor.

### C. REGJISTRIMI I PARTIVE, KANDIDATËVE, DHE LISTAT SHUMËMËRORE

KQZ-ja regjistroi 38 parti. Disa prej tyre nuk dorëzuan lista kandidatësh dhe të tjera morën pjesë në koalicione. Pra, 28 parti dhe koalicione paraqitën lista shumëemërore për votimin proporcional. Përveç kësaj, disa parti morën pjesë vetëm në konkurrimet në zonat njëemërore.

Para raundit të parë, lindi një konflikt ligjor midis Partisë Demokratike dhe partisë së shkëputur prej saj të quajtur Partia Demokrate për përdorimin e shkronjave nistore dhe stemës. Të dyja partitë pretendonin pronësinë mbi shkronjat nistore “PD”, dhe të drejtën e përdorimit të këtyre shkronjave nistore në fletën e votimit. Më 29 maj, përpara se të shtypeshin fletët e votimit, Gjykata e Apelit të Tiranës i dha Partisë Demokratike të drejtën ekskluzive për shkronjat nistore “PD” dhe vendosi se KQZ-ja kishte gabuar kur plotësoi kërkesën e Partisë Demokratike për të përfshirë shkronjat nistore “PD” në fletën e votimit përkrah atyre të BF-së. Megjithatë, Partia Demokrate nuk arriti të sigurojë në kohë një “urdhër ekzekutiv” para fillimit të shtypjes së fletëve të votimit dhe fletët e votimit u shtypën më 8 qershor me shkronja nistore “PD”, si për Partinë Demokrate, ashtu edhe për BF-në.

Një total prej 1 114 kandidatësh u regjistrua në të 100 zonat njëemërore. Nga këta, 149 u regjistruan fillimisht si kandidatë “të pavarur”. KZZ-të refuzuan relativisht pak kandidatë, ndonëse procedurat për shqyrtimin e dokumentacionit nuk u zbatuan në mënyrë koherente në të gjitha zonat. Njëzet kandidatë të refuzuar apeluan pranë KQZ-së, e cila si pasojë rivendosi 11 dhe refuzoi nëntë. Vetëm tre nga këta të nëntë apeluan në gjykata.

Në një përpjekje për ta vënë në provë ligjin tej kufijve të pranueshëm dhe për të fryrë numrin e mandateve plotësuese që i takonin nëpërmjet votimit proporcional, PS-ja shpalli paraqitjen e 80 kandidaturave të “PS-së” në të 100 zonat njëemërore dhe “mbështetjen” për 20 kandidatë “të pavarur” në zonat e mbetura. Në përgjigje të kësaj, PD-ja dhe aleatët e saj në BF deklaruan se do të regjistronin shtatë kandidatë zyrtarë në emër të BF-së dhe 93 kandidatë si “të pavarur”.

Partitë e vogla nga aleanca e mëparshme qeverisëse të bashkuara me BF-në në një “tryezë të rrumbullakët”, u përpoqën të bindnin KQZ-në se, për të siguruar përfaqësim proporcional në Kuvend në përputhje me frymën e Kushtetutës dhe Kodit Zgjedhor, këta kandidatë “të pavarur” duhet të klasifikoheshin si kandidatë partiakë. Megjithëse nuk i ankimuan pranë KQZ-së vendimet individuale të KZZ-ve për regjistrimin e kandidatëve, apo nuk i apeluan pranë gjykatave vendimet e KQZ-së që konfirmonin këto regjistrime, ashtu siç përcaktohet në ligj, tre parti politike ngritën padi

pranë Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar shpalljen e nenit në tërësi si jokushtetues.<sup>9</sup> Më 2 qershor, Gjykata shpalli kushtetueshmërinë e nenit 66, duke refuzuar në këtë mënyrë të shmangte pjesëmarrjen e të ashtuquajturëve “kandidatë të pavarur”.<sup>10</sup>

Në përgjigje të argumentave nga “tryeza e rrumbullakët”, më 3 qershor, KQZ-ja lëshoi një udhëzim i cili kufizonte “mbështetjen” e partisë politike deri në 20 kandidatë “të pavarur”. Më 4 qershor, KQZ-ja kërkoi një konsultim me partitë politike për këtë çështje. Të gjitha partitë, përveç PS-së, ranë dakort që ky udhëzim nuk e zgjidhte problemin dhe ata këmbëngulën që KQZ-ja ta abrogonte atë. KQZ-ja e plotësoi këtë kërkesë pak kohë përpara përfundimit të afatit për regjistrimin e kandidatëve në mesnatën e datës 4 qershor. Këto zhvillime çuan në krijimin e pasigurisë gjatë periudhës kritike të regjistrimit të kandidatëve, periudhë e cila zgjati deri disa ditë para raundit të parë.

Më në fund, më 20 qershor, në bazë të dokumentacionit dhe provave të disponueshme, KQZ-ja vendosi t’ia përllogariste mandatet e 7 kandidatëve “të pavarur” PS-së dhe ato të 41 kandidatëve “të pavarur” BF-së, në qoftë se ata do të zgjidheshin.<sup>11</sup> Menjëherë PS-ja apeloi në Gjykatën e Apelit të Tiranës, e cila e shpalli të vlefshëm vendimin e KQZ-së. Më 23 qershor, pas një vendimi tjetër të KQZ-së, vetëm 5 prej 112 kandidatëve “të pavarur” fillestarë të mbështetur nga partitë politike mbetën si “të pavarur”.<sup>12</sup> Megjithatë, regjistrimi i 107 kandidatëve të riklasifikuar nuk mund të ndryshohej dhe fletët e votimit u shtypën me cilësimin “i pavarur” përkrah emrave të tyre.

Dy nga ish-“të pavarurit” e PS-së, Nikollë Lesi (Zona 13, pronar i një mediaje private me influencë) dhe Agron Duka (Zona 25, ish-Prefekti i Durrësit), si edhe Llesh Kola (Zona 13) dhe dy “të pavarur” të BF-së u cilësuan nga KQZ-ja si kandidatë “vërtet të pavarur”. Pra, KQZ-ja arriti, ndonëse në një fazë tepër të vonë, të zgjidhë këtë çështje. Por megjithatë, mbetën disa probleme. PS-ja nuk regjistroi kandidatë as në Zonën 13 dhe as në Zonën 25, zyrtarë të lartë të PS-së treguan një prani të theksuar në ngjarjet e fushatës së Lesit, dhe Lesi ishte i vetmi kandidat “i pavarur” që arriti të blejë kohë televizive publicitare në transmetuesin publik, duke shkelur nenin 132(4) të Kodit Zgjedhor i cili përcakton se “Radiotelevizioni Publik nuk mund të përgatisë ose transmetojë reklama politike me pagesë.” Përveç kësaj, fitoret si të Lesit, ashtu edhe të Dukës, u konfirmuan pas procesesh gjyqësore të diskutueshme dhe PD-ja nuk e tërhoqi kurrë mbështetjen e saj për të tre kandidatët “e pavarur” që mbetën.

#### D. REGJISTRI I VOTUESVE

Gjatë vitit 2000, autoritetet shqiptare, me ndihmën e komunitetit ndërkombëtar, ndërmorën krijimin e një regjistri kombëtar votuesish të kompjuterizuar. Edhe pse kjo shënon një hap domethënës për të afruar më tej vendin me praktikat evropiane në përcaktimin e së drejtës së zgjedhësve për të votuar, përsëri mbetën mangësi, përfshirë rekorde të dubluara ose rekorde që mungonin, rekorde të caktuara në qendrën e gabuar të votimit, procesverbale me datëlindje të pasakta, dhe gabime të tjera të dhënash.

Disa nga mangësitë në regjistrin e votuesve u korrigjuan pjesërisht gjatë përgatitjeve për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001. Në përgjithësi, u korrigjuan kategori të caktuara rekordesh të dubluara. Përveç kësaj, kërkesa për ngjyrosjen e gishtit të votuesve me bojë të pashlyeshme u përfshi në

<sup>9</sup> Padia u ngrit nga PSD-ja, PAD-ja dhe PBDNj-ja.

<sup>10</sup> Megjithatë, Gjykata shfuqizoi një paragraf të nenit 66, i cili trajtonte një çështje tjetër, mandatin e fituar nga një kandidat i emëruar në mënyrë të përbashkët.

<sup>11</sup> Vendimi i KQZ-së nr. 890, 20 qershor 2001.

<sup>12</sup> Vendimi i KQZ-së nr. 905, 22 qershor 2001.

Kodin Zgjedhor si një masë sigurie për të shmangur votimim e shumëfishtë. Për më tepër, mbi bazën e një marrëveshjeje ndërmjet partive politike, autoritetet zhvilluan një veprimtari të një shkalle të gjerë për të rishqyrtuar regjistrin e mëparshëm të votuesve me anën e ekipeve prej tre anëtarësh, të cilët përfshinin përfaqësues të partisë qeverisëse, të opozitës dhe të administratës vendore. Kjo nismë u mbështet nga një fushatë e dendur sensibilizimi të votuesve. Ndonëse nevojiten përmirësime të mëtejshme në regjistrin e votuesve, kjo përpjekje koherente vlen të përshëndetet.

Për të dhënë më tepër siguri shtetasve për ushtrimin e së drejtës për të votuar, në maj të vitit 2001, u amendua Kodi Zgjedhor për të lejuar shtetasit me të drejtë votimi të rifreskonin të dhënat e tyre në regjistrin e votuesve deri në 24 orë përpara ditës së zgjedhjeve duke apeluar në gjykatat e rretheve. Megjithatë, kërkoheshin tri çertifikata për të vërtetuar të drejtën e votës dhe si përfundim, numri i rasteve të apelimit në gjykata ishte modest. Një faktor tjetër për gabimet që mbetën për një kohë të gjatë në regjistrat e votuesve ishte mosnjoftimi në kohën e duhur, apo fare, nga një pjese e madhe e popullsisë, për ndryshimet në vendqëndrimet e përhershme, ose në mënyrë më të përgjithshme mosbindja ndaj procedurave ekzistuese të regjistrimit civil. Pëveç kësaj, teknologjia e papërsosur, mungesa e përvojës dhe shpesh, shkujdesja kontribuan gjithashtu në shfaqjen e gabimeve në variantin fillestar të bazës së të dhënave për regjistrin e votuesve. Gjithashtu, OSBE/ODIHR-i morën ankesa nga votuesit se emrat e tyre ishin përfshirë në listat paraprake të votuesve, por nuk ishin përfshirë në listat përfundimtare të votuesve.

Numri i verifikuar i votuesve të regjistruar për zgjedhjet e qeverisjes vendore të vitit 2000, i përdorur për të përcaktuar kufijtë e zonave për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001, ishte 2329639. Regjistrat paraprake të votuesve për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 u rritën në shifrën 2449404, ndërsa regjistri përfundimtar përmbante 2499238 hyrje që nga 15 qershori. Votimi jashtë vendit nuk u lejua. Megjithëse disa ekspertë do të pretendonin se kjo shifër mbivlerëson numrin e votuesve në Shqipëri, përfshirë këtu edhe ata që banojnë jashtë vendit, por që adresat e të cilëve vazhdojnë të jenë ende të regjistruara brenda vendit, OSBE/ODIHR-i vazhdoi të merrte ankesa se një numër i lartë votuesish u la qëllimisht jashtë regjistrave të votuesve. Gjithashtu, pati prova për shmangie të tepruara në numrin e votuesve të regjistruar në zonat njëmërore më tepër se pesë për qindshi i rekomanduar.

Regjistrat e votuesve nuk u rifreskuan për raundin e dytë dhe as zgjedhjet që pasuan, sepse nuk u përcaktua asnjë procedurë ligjore për shtimin e individëve në regjistra pas 23 qershorit. Dispozita e Kodit Zgjedhor lejonte regjistrimin shtesë të votuesve me anën e një vendimi të gjykatës 24 orë përpara ditës së votimit, u interpretua nga shumica e gjykatave të rretheve si 24 orë përpara raundit të parë të zgjedhjeve, pra, duke parandaluar regjistrime shtesë.

## VI. PJESËMARRJA E GRAVE NË PROCESIN ZGJEDHOR

Parimi i barazisë midis burrave dhe grave përcaktohet në nenin 18 të Kushtetutës: “të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”, dhe “askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia...” Sipas një raporti mbi barazinë gjinore të publikuar nga Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (PNUD), “legjislacioni shqiptar parashikon konceptin e barazisë midis grave dhe burrave, por ende jo konceptin e mundësive të barabarta. Sistemi nuk merr parasysh se [në qoftë se] grave ju duhet...për të arritur mundësi të barabarta, ato kërkojnë masa të veçanta. Deri tani, nuk është paraqitur asnjë masë veprimi që pohon shpejtimin e vendosjes së barazisë.”<sup>13</sup>

<sup>13</sup> PNUD Raporti Kombëtar Shqiptar për Gratë (1999).

Megjithëse tepër aktive në nivelin bazë në politikën shqiptare, dhe megjithëse u është garantuar një përqindje e posteve të larta brenda disa prej partive politike, në përgjithësi gratë përballen me vështirësi në përzgjedhjen e tyre si kandidatë dhe në marrjen e posteve drejtuesve në partitë politike. Vetëm 78 prej 1114 kandidatëve (7%) që konkurronin për t'u zgjedhur në zonat njëemërore dhe 120 prej 823 kandidatëve (15%) në listat proporcionale ishin gra, dhe pati akoma më pak gra që kryesonin në listë me një mundësi të arsyeshme për t'u zgjedhur. Vetëm Partia Alternativa Liberale pati një grua në krye të listës së vet partiake. Gjithashtu, gratë u përfaqësuan pak në strukturat administrative të zgjedhjeve. Asnjë nga anëtarët me të drejta të plota nuk ishte grua dhe vetëm 7% e anëtarëve të KZZ-ve dhe 8% e anëtarëve të KQV-ve, të cilat u vëzhguan nga monitoruesit ndërkombëtarë më 24 qershor, ishin gra. Kodi zgjedhor nuk përcakton për diskriminim pozitiv në favor të grave.

Megjithatë, pothuajse të gjitha partitë politike dhe koalicionet përfshinë referenca për shqetësime të lidhura me çështje gjinore në programet e tyre politike dhe disa ngjarje të organizuara zgjedhore u përqëndruan në mënyrë të veçantë rreth votuesve gra. Disa prej këtyre ngjarjeve u pasqyruan në gazetatat kombëtare. Gjithashtu, transmetuesi publik e përqëndroi vëmendjen mbi gratë votuese nëpërmjet një sërë programesh të veçanta duke portretizuar politikane të njohura.

Rezultatet e zgjedhjeve në zonat njëemërore treguan se vetëm shtatë gra fituan. Një vend shtesë iu akordua një gruaje me ndarjen e mandateve "plotësuese". Kuvendi i ri do të përfshijë tetë gra (5.71%), në krahasim me 11 gra në Kuvendin pak më të madh të vitit 1997,<sup>14</sup> një shifër kjo që nuk përfaqëson plotësisht fuqinë e tyre aktuale në shoqërinë shqiptare.

## FUSHATA

Fushata për raundin e parë u zhvillua kryesisht në një atmosferë të qetë me pak njoftime për dhunë ose kërcënime. U zhvillua një numër i madh manifestimesh rajonale dhe veprimtaria e fushatës në nivelin lokal ishte e dukshme në shumicën e zonave. Të dyja partitë kryesore ishin dukshëm të përmbajtura në retorikën e fushatës, duke pakësuar tensionin e përgjithshëm gjatë fushatës.

Partitë e opozitës u ankuan për shqetësime dhe pengesa të vogla si heqja e posterave. Gjithashtu, MVZ-ja mori njoftime për përdorimin e papërshtatshëm të pasurive shtetërore nga partia qeverisëse për qëllime të fushatës, akuza të izoluara të abuzimit nga ana e policisë dhe ndërhyrje shtetërore në punën e komisioneve zgjedhore. Megjithëse është për të ardhur keq, nuk u duk se këto veprime ishin domethënëse deri në atë shkallë sa të minonin integritetin e zgjedhjeve në raundin e parë.

Fushata zgjedhore midis raundit të parë dhe të dytë përgjithësisht tërhoqi pak vëmendje, dhe për pjesën më të madhe u zhvillua në një atmosferë të qetë dhe paqësore. U zhvilluan më pak manifestime dhe takime sesa gjatë periudhës së përgatitjeve për raundin e parë. Pjesa më e madhe e debateve u përqëndrua në rezultatet e raundit të parë, ankesat përkatëse dhe rreth krijimit të alenacave për raundin e dytë. PS-ja mori një mbështetje të luhatshme nga ish-partnerët qeverisës të "Aleancës për Shtetin". Fatkeqësisht, u vu re një farë rritjeje e retorikës agresive. Në Zonën 60, ku u zhvillua votimi për proporcionalin në shkallë vendi për herë të parë më 8 korrik, PS-ja ju bëri thirrje mbështetësve të vet për të votuar për tre nga ish-aleatët e saj në qeveri, PAD-në, PA-në dhe PBDNj-në. Në raundin e dytë BF-ja kërkoi mbështetjen e Partisë Demokrate, por Partia Demokrate ua la vendimin degëve lokale.

<sup>14</sup> Kuvendi i vitit 1997 kishte 155 deputetë.

Pati një veprimtari fare të ulët për fushatë pas raundit të dytë dhe atmosfera përgjatë gjithë periudhës së mbetur të zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë.

## **MEDIA**

### **A. PANORAMA E MEDIAS**

Skena e medias shqiptare po ndryshon me shpejtësi, ku shumë stacione radio dhe televizione janë krijuar gjatë këtyre pak viteve të fundit. Transmetuesi publik *Televizioni Shqiptar* (TVSH) mbulon të gjithë territorin shqiptar.<sup>15</sup> Dy stacione televizione private, *TV Arbëria* dhe *TV Klan*, kanë gjithashtu një mbulim thuajse kombëtar. Përveç kësaj, 37 stacione televizione lokale dhe 42 stacione radio transmetojnë në vend. Dy prej stacioneve të radios, duke përfshirë stacionin publik të radios “Radio Tirana” mbulojnë të gjithë territorin.

Sipas Institutit për Studime Publike dhe Ligjore, Shqipëria ka 13 gazeta të përditshme me një tirazh të përgjithshëm prej përafërsisht 95000 kopjesh. Për arsye të një shpërndarjeje të dobët dhe të mungesës së një sistemi të abonimeve, edhe ato gazeta që aspirojnë të lexohen në shkallë kombëtare shpërndahen vetëm në qytete. Si shumë vende të tjera në tranzicion, shqiptarët kanë prirjen të përzgjedhin më tepër transmetimet televizione, se sa lajmet e botuara, duke e vështirësuar mbijetesën e shumë gazetave.

### **B. RREGULLAT E MEDIAS**

Kodi Zgjedhor rregullon pasqyrimin e fushatës nga media elektronike private dhe publike. Fushata kufizohet brenda 30 ditëve duke përfunduar 24 orë përpara fillimit të votimit. Publikimi i sondazheve të opinionit publik ndalohet gjatë pesë ditëve të fundit të fushatës. Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT) përgjigjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe shqyrtimin e ankesave në lidhje me pasqyrimin e fushatës nga media elektronike private dhe publike.<sup>16</sup>

Në përputhje me Kodin Zgjedhor, KQZ-ja vendosi që partive parlamentare t’u jepej e drejta për 28 minuta dhe 8 sekonda kohë transmetimi pa pagesë në radion dhe televizionin publik nga ora 18:00 deri në 22:00 gjatë fushatës zgjedhore, kurse partive joparlamentare t’u jepej e drejta për 10 minuta kohë transmetimi pa pagesë. Kandidatët e pavarur mundën të merrnin kohë transmetimi pa pagesë vetëm në raundin e dytë. Televizionet dhe radiot private mund të transmetonin reklama për partitë politike, por ishin të detyruara t’u ofronin të gjitha partive pjesëmarrëse në fushatë tarifën e tyre më të ulta për periudhën e kërkuar kohore. Përveç kësaj, radiot dhe televizionet private nuk mund të transmetonin reklamë më tepër se pesë minuta në ditë për secilën parti politike apo kandidat të pavarur.

### **C. MONITORIMI I MEDIAS**

---

<sup>15</sup> Ligji *Për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat në Republikën e Shqipërisë* - nr 8410, datë 30 shtator 1998 rregullon aktivitetin e TVSH-së dhe përcakton Këshillin Drejtues të Radio Televizionit Publik (RTSH), të përbërë prej 15 anëtarësh të emëruar nga Kuvendi, përgjegjës për drejtimin e transmetuesit publik.

<sup>16</sup> Gjithashtu, KKRT-ja zhvilloi një shërbim monitorimi për të kontrolluar veprimtarinë e mediave kryesore në vend gjatë fushatës.

MVZ-ja monitoroi fushatën zgjedhore në TVSH, TV Klan, and TV Shijak për 6 orë në ditë nga ora 18:00 deri 24:00, nga 28 maj deri 6 korrik. Gjithashtu, MVZ-ja monitoroi pesë gazeta të përditshme (*Albania, Gazeta Shqiptare, Koha Jonë, 55, Shekulli*).

Një spektër i gjerë i mediave përcolli informacion të shumëllojshëm për zgjedhjet, duke iu dhënë rastin votuesve për të bërë një zgjedhje të mirëinformuar. Pati një debat të vërtetë politik dhe kandidatëve iu dha hapësirë dhe kohë për të paraqitur platformat e tyre. Pasqyrimi më i madh iu kushtua PS-së dhe BF-së dhe të dyja patën raste të mjaftueshme për të paraqitur programet e tyre politike. Partia Demokrate e re mori gjithashtu një pasqyrim domethënës. Toni i fushatës ishte në mënyrë domethënëse më i moderuar sesa në zgjedhjet e mëparshme, megjithëse MNVZ-ja vërejti një retorikë të përkeqësuar politike pas raundit të parë.

Pas raundit të parë, debatet zgjedhore ishin të kufizuara dhe pasqyrimi politik u përqëndrua në buletinet e lajmeve televizive. Pati një pakësim të ngjashëm të pasqyrimin të zgjedhjeve por më pak domethënës në media e shkruar. Si media elektronike ashtu edhe ajo e shkruar pasqyruan gjerësisht proceset e ankesave dhe apelimeve, duke përfshirë këtu akuzat për manipulim zgjedhor të ngritura si nga pozicionet qeverisëse, ashtu edhe ato opozitare.

Përpara raundit të parë, transmetuesi publik (TVSH) dhe disa media private ju ofruan përgjithësisht një hapësirë të ekuilibruar kohore konkurruesve kryesorë në zgjedhje, dhe raportuan mbi veprimtarinë e tyre në mënyrë të drejtë. TVSH-ja i caktoi PS-së 30% të kohës kushtuar politikës dhe zgjedhjeve, 17% qeverisë, 24% BF-së dhe pjesa e mbetur prej 29% partive të vogla. Toni i pasqyrimin ishte ose politikisht i paanshëm, ose pozitiv për të gjithë konkurrentët. Megjithatë, gjatë ditëve të fundit të fushatës përpara raundit të parë, pasqyrimi dhe toni ishin më të njëanshëm në favor të PS-së. Ndërmjet raundit të parë dhe të dytë, TVSH-ja nuk arriti të përmbushë përgjegjësitë e veta si transmetues publik, dhe i kushtoi 40% të pasqyrimin politik PS-së, dhe vetëm 11% BF-së. Në mënyrë domethënëse, pasqyrimi i PS-së ishte pozitiv, ndërsa pjesa më e madhe për BF-në ishte një pasqyrim i paanshëm. Pas një paralajmërimi më 16 korrik, KKRT-ja e gjobiti TVSH-në për njëanshmëri në favor të PS-së në periudhën përpara raundit të dytë. Kjo mungesë e ekuilibrit politik nga transmetuesi publik përbënte një mangësi serioze.

Ndërsa në periudhën përpara raundit të parë, disa media private caktuan një ndarje të kohës përgjithësisht të ekuilibruar për konkurrentët kryesorë në zgjedhje, shumica e mediave mbështetën një nga të dy konkurrentët kryesorë. TV Klan ofroi një pasqyrim të balancuar, kryesisht pozitiv apo të paanshëm në periudhën përpara raundit të parë. TV Shijak mbështeti haptazi BF-në. Ndërmjet raundit të parë dhe të dytë, TV Klan ofroi një pasqyrim më pak të ekuilibruar, duke favorizuar PS-në, kurse TV Shijak ishte haptazi në favor të BF-së.

Përpara raundit të parë, gazetat e monitoruara i kushtuan BF-së 39% të hapësirës kushtuar politikës dhe zgjedhjeve, PS-së 30% dhe qeverisë 14%. Pasqyrimi tregoi një tendence më të dukshme drejt raportimit dhe komenteve negative polemike sesa media elektronike, ku PS-ja dhe qeveria ishin kryesisht në shenjë. Ndërmjet raundit të parë dhe të dytë, gazetat ofruan një pasqyrim të barabartë si për pozicionin qeverisës ashtu edhe atë opozitar. Megjithatë, vazhdoi prirja e disa mediave të shkruara drejt njoftimeve dhe komenteve negative polemike, veçanërisht në lidhje me PS-në dhe qeverinë.

MVZ-ja vërejti një numër shkeljesh të Kodit Zgjedhor:

- Nikollë Lesi, që konkuroi si një kandidat i pavarur, pretendoi se kishte marrë një autorizim nga KQZ-ja për të blerë kohë televizive në TVSH, duke shkelur nenin 132/4 të Kodit Zgjedhor, i cili ndalon televizionin publik që të shesë kohë transmetimi.

- Sondazhet e opinioneve u publikuan pa bërë publike hollësitë e sondazhit (emrin e intervistuesit, sponsorit, madhësinë e kampionit, kufirin e gabimit dhe periudhën kohore gjatë së cilës u zhvillua sondazhi) siç kërkohet në nenin 130(3) të Kodit Zgjedhor.
- TV Shijak transmetoi spote që përmbanin propagandë për PD-në nga një i huaj, në disa raste, duke mospërfillur paralajmërimet e KKRT-së dhe duke shkelur nenin 130(5) të Kodit Zgjedhor.
- Pothuajse të gjitha mediat shkelën periudhën e heshtjes zgjedhore, e detyrueshme nga ligji gjatë 24 orëve përpara raundit të parë.

## IX. VËZHguesIT VENDAS

Kodi zgjedhor u ofroi vëzhguesve vendas akses të plotë në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore dhe në dokumentat përkatëse. Gjithashtu, vëzhguesit vendas mund t'iu paraqesin komente me shkrim komisioneve zgjedhore për të gjitha parregullsitë që ata vërejnë.

Tre organizata jo-qeveritare të vëzhguesve vendas, Shoqata për Kulturë Demokratike,<sup>17</sup> Komiteti Shqiptar i Helsinkit, dhe Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut regjistruan mbi 1000 vëzhgues për të monitoruar zgjedhjet. Grupet njoftuan se nuk pati probleme në marrjen e akreditimit për vëzhguesit e tyre, ose në dhënien e aksesit në të gjitha aspektet e procesit zgjedhor. Gjithashtu, grupet njoftuan për një përmirësim të marrëdhënieve me partitë politike dhe bashkëpunim të mirë me komisionet zgjedhore. Vëzhguesit vendas ishin të pranishëm në 20% të qendrave të votimit të vizituara nga vëzhguesit ndërkombëtarë më 24 qershor.

## X. VËZHGIMI I VOTIMIT, NUMËRIMIT DHE PASQYRIMIT TË REZULTATEVE

### A. VOTIMI

KQV-të patën një përbërje të ekuilibruar politike dhe në qendrat e votimit të vizituara nga vëzhguesit, Kryetarët ishin të caktuar nga PS-ja në 40% të rasteve dhe BF-ja në 53% të rasteve. Shumica e anëtarëve të KQV-ve arritën të linin mënjanë mosmarrëveshjet e tyre politike dhe të bashkëpunonin me kolegët e tyre. Megjithëse, në përgjithësi, KQV-të ndoqën procedura të drejta votimi, u pa qartë një mungesë trajnimi. Vëzhguesit njoftuan për raste ku dokumentet e identifikimit të votuesve nuk u kontrolluan në mënyrë të vazhdueshme, si edhe raste të aplikimit ose jo të ngjyrosjes së gishtit të votuesit – një procedurë që kishte për qëllim të shmangte rastet e votimit të dyfishtë. Votimi me përfaqësim ishte një problem në disa nga qendrat e votimit dhe pati raste ku u vu re që votuesit mbanin në dorë më shumë se një fletë votimi. Fshehtësia e votës u minua shpesh sepse KQV-të nuk arritën të shmangnin votimin në grupe. Probleme të tjera që u raportuan përfshinin praninë e individëve të paautorizuar, kryesisht aktivistë partiakë, dhe materiale të fushatës.

Votimi në raundin e parë më 24 qershor ishte i qetë, dhe me përjashtim të disa incidenteve të dhunshme të izoluara, ai u vlerësua pozitivisht nga vëzhguesit zgjedhorë. Vështirësia kryesore që ata hasën ishin një numër i vogël individish në më shumë se gjysmën e qendrave të votimit të vizituara nga vëzhguesit, të cilët nuk gjetën emrat e tyre në regjistrat e votuesve dhe u kthyen mbrapsht. Disa u ankuan se emrat e tyre kishin qenë në listën paraprake të votuesve, dhe mungonin nga lista përfundimtare. Megjithatë, të paktën disa prej këtyre votuesve ishin të regjistruar në qendra

<sup>17</sup> Në bashkëpunim me Qendrën për Zgjedhje të Lira dhe Demokraci – (CeSID) nga Serbia.



votimi diku gjetkë. Mosmarrëveshjet politike ndërmjet anëtarëve të KZZ-së dhe KQV-së sollën dështimin e zhvillimit të zgjedhjeve në Zonën 60 dhe në 25 qendra votimi në pesë zona të tjera. Në prag të zgjedhjeve, kjo shifër u duk edhe më e lartë. Megjithatë, Kryetari i KQZ-së ndërhyri në mënyrë vendimtare dhe urdhëroi policinë lokale të shpërndajë materialet zgjedhore në një numër zonash.

Gjatë raundit të parë të votimit në 24 qershor, pati incidente të izoluara por domethënës të ushtrimit të presionit dhe të ndërhyrjes nga ana e policisë dhe të autoriteteve vendore. Disa prej këtyre incidenteve përfshinin veprime në favor të kandidatëve të partisë qeverisëse. Në shumë raste, u raportua një prani e tepruar e policisë dhe në disa raste u vërejt se policia u soll në një mënyrë të papërshtatshme dhe të njëanshme. Gjithashtu, u vërejtën civilë të armatosur, si p.sh. në Zonën 18. Në disa raste të rralla, policia u përfshi në manipulimin e materialeve zgjedhore. Për shembull, në Zonën 49, një vëzhgues ndërkombëtar njoftoi për mbushjen e kutive të votimit me fletë votimi nga policia në KQV-në 46 gjatë pasdites. Zyrtarët zgjedhorë përkatës e konfirmuan incidentin. E njëjta qendër votimi u bë përsëri problematike më 22 korrik. Në Zonën 19 një oficer madhor policie i mohoi vëzhguesit të OSBE/ODIHR-it hyrjen në KZZ. Më 23 qershor në Zonën 60, policia ndërpreu shpërndarjen e materialeve zgjedhore me kërkesë të Zëvendës Kryetarit të KZZ-së të PS-së. Një oficer madhor policie e konfirmoi këtë incident tek një vëzhgues ndërkombëtar. Argumentet sipas të cilave Zëvendës Kryetari i kërkoi policisë të ndalojë shpërndarjen e materialeve zgjedhore, si edhe arsyeja për të cilën policia ndaloi shpërndarjen mbeten të paqarta. Shpjegimet e autoriteteve për këto zhvillime ndaj OSBE/ODIHR-it nuk hodhën dritë të mëtejshme.

Më 8 korrik, gjatë raundit të dytë, qendrat e votimit funksionuan në mënyrë profesionale dhe përgjithësisht votimi vazhdoi pa incidente. Megjithatë, vëzhguesit njoftuan për një tension në rritje në krahasim me raundin e parë, sidomos në pjesë të Tiranës dhe të Durrësit. Pati raste që ata e ndjenë veten të kërcënuar (në Zonat 35 dhe 97) dhe, në Zonën 95, një ekip u pengua në kryerjen e vëzhgimit të tij. Ashtu si në raundin e parë, një numër i kufizuar shtetasish shkuan në qendrat e votimit për të zbuluar se emrat e tyre mungonin në listën e votuesve dhe se nuk u zbatua asnjë procedurë efikase për të korrigjuar këtë mangësi. Disa shkelje serioze krijuan shqetësim, duke përfshirë mbushjen e kutive të votimit që u raportua në Zonat 25 dhe 28, raste të fletëve të votimit të parashenjuara u zbuluan në Zonat 25, 60 dhe 61. Në Zonën 22, në të vetmen qendër votimi që nuk arriti të zhvillonte votimin në raundin e parë, një bojkot nga 3 anëtarë të KQV-së, përfshirë anëtarin e PS-së, u pasua nga prishja e veprimeve të votimit nga një njeri i armatosur. Si pasojë, i njëjti individ propozohet nga PS-ja si përfaqësues i tyre në KQV për përsëritjen e votimit më 22 korrik, ndonëse më vonë emri i tij u tërhoq. KQZ-ja vendosi të shpallë të pavlefshme rezultatet në zonën 49 për shkak të parregullsive serioze, që përfshinin raportimin nga qendrat e votimit të një pjesëmarrjeje në votim më shumë se 100% dhe një mungese të procesverbaleve të besueshme. Gjithashtu, vëzhguesit vendas njoftuan për një numër shkeljesh serioze në këtë zonë më 8 korrik. Bazuar në procesverbalin e KZZ-së, kandidati i PS-së fitoi 82 % të votave, një rezultat i dyshimtë ky nëse e krahasojmë me votimin e raundit të parë, kur ai fitoi 46% në krahasim me 37% nga kandidati i BF-së. Më 8 korrik, u zhvilluan konkurrimet e raundit të dytë në 52 zona të pjesshme apo të plota. Nuk u zhvilluan zgjedhje në Zonën 86 dhe as në një numër qendrash votimi në Zonat 2, 4, 22, 49, dhe 61, për shkak të ndërprerjes së përgatitjeve zgjedhore nga anëtarët e KZZ-së ose KQV-së. Votimi në Zonën 60 u zhvillua vetëm pas ndërhyrjes së KQZ-së një natë më parë.

Gjatë raundit të dytë, pati një prani mjaft të dukshme të policisë gjatë ditës së votimit dhe, pati raste ndërhyrjeje në procesin zgjedhor. Disa nga këto ndërhyrje ishin serioze si në rastin kur policia mori me vete në mënyrë të pajustificueshme një kuti votimi në një qendër votimi në Zonën 35. Gjithashtu, ishin shqetësuese njoftimet që pretendonin për kërcënime dhe ndalime nga policia të disa anëtarëve të KZZ-ve dhe KQV-ve, kryesisht nga ana e PD-së.

Zgjedhjet u përsëritën në 11 zona në raundin e tretë më 22 korrik. Përsëri ishin gjerësisht të qeta dhe të vlerësuara pozitivisht në shumicën e qendrave të votimit. Megjithatë, u njoftuan shkelje serioze në një numër qendrash votimi. Këto përfshinin mbushje të kutive të votimit nga ana e anëtarëve të komisioneve në të vetmen qendër votimi ku u zhvilluan zgjedhjet në Zonën 22, ku deri në orën 17:00 kur qendra e votimit u mbyll herët, 98% të votuesve me të drejtë vote u regjistruan sikur kishin votuar, pavarësisht se vëzhguesit dëshmuuan për një pjesëmarrje të pakët. Gjithashtu, u raportua mbushja e kutive nga një anëtar i komisionit në KQV-në 202 të Zonës 40, ku u shty votimi për një farë kohe, pasi u zbulua se kishte pesë fletë votimi më tepër se sa nënshkrime në listën e votuesve. Në një qendër votimi në Zonën 4, nuk mund të kishte patur një proces zgjedhor të ligjshëm sipas kërkesës së Kodit Zgjedhor, përderisa qendra e votimit nuk u hap deri në orën 15:00. Megjithatë, më vonë, vëzhguesit dëshmuuan se anëtarë të komisionit nga kjo qendër votimi mbërritën në KZZ më një kuti votimi që përmbante 290 fletë votimi. KQZ-ja vendosi të përsëriste votimin në të gjitha qendrat e votimit në Zonën 49, por Gjykata Kushtetuese vendosi të kufizojë numrin e qendrave të votimit ku do të përsëriteshin zgjedhjet. Për pasojë, në prag të raundit të tretë, BF-ja vendosi të bojkotonte zgjedhjet në këtë zonë. Vëzhguesit njoftuan për probleme në këtë zonë gjatë votimit më 22 korrik, duke përfshirë nënshkrime të dyshimta në regjistrin e votuesve në KQV-në 46.

Gjatë raundit të tretë, vëzhguesit njoftuan për sjelljen e policisë në shumicën e zonave, duke e përshkruar atë si të përshtatshme. Nuk u njoftua asnjë rast i ndërhyrjes policore gjatë këtij procesi, megjithëse prania e policisë ishte e tepruar përreth disa qendrave të votimit në zonat 2, 14, 18, 22 dhe 86.

## **B. NUMËRIMI**

Në përgjithësi, sjellja gjatë numërimit ishte e kënaqshme, megjithëse, shpesh procedurat teknike nuk u zbatuan në mënyrë korrekte. Problemet e vërejtura përfshinë praninë e personave të paautorizuar, dështimin e disa KQV-ve për të përmbushur procesverbalet e rezultateve me bojë shkrimi dhe refuzimin e disa anëtarëve të KQV-ve për të nënshkruar procesverbalet e rezultateve. Disa anëtarë të KQV-ve dorëzuan ankesa me shkrim. Pas përfundimit të numërimit, përgjithësisht, KQV-të ua dërguan pa u vonuar rezultatet KZZ-ve.

Në raundin e parë më 24 qershor, vëzhguesit njoftuan për gjendje të tensionuar në disa qendra votimi gjatë numërimit dhe, në një numër të vogël rastesh, njoftuan se anëtarët e KQV-ve e penguan procesin. Megjithatë, vetëm në një qendër votimi u vërejt një incident i dhunshëm dhe nuk u njoftua asnjë rast kërcënimi ndaj anëtarëve të KQV-ve. Në raundin e dytë, vëzhguesit njoftuan se atmosfera gjatë numërimit ishte dukshëm më e tensionuar sesa gjatë votimit dhe ata shfaqën shqetësim rreth numrit relativisht të lartë të fletëve të pavlefshme të votimit në disa qendra votimi.

Më 22 korrik gjatë raundit të tretë, në një incident serioz në KQV-në 14 të Zonës 2, vëzhguesit mbërritën pranë qendrës së votimit në 15:45 dhe zbuluan se kishte filluar numërimi i votave dhe se ky proces po drejtohej nga një njeri i armatosur, i cili nuk ishte anëtar i KQV-së. Gjithashtu, më 22 korrik, në një incident tjetër serioz në Zonën 4, Sekretari i KZZ-së i kërkoi një vëzhguesi të dorëzonte përsëri procesverbalin e marrë nga KQV-ja 2 në këtë zonë.

## **C. PASQYRIMI I REZULTATEVE TË ZGJEDHJEVE**

Pasqyrimi i rezultateve ishte në përgjithësi i ngadaltë dhe, në disa raste, ngjalli polemika. Ndërkohë që shumica e KZZ-ve i shpalli rezultatet brenda afatit ligjor dyditor pas datës së zgjedhjeve dhe ia transmetoi pa u vonuar rezultatet KQZ-së, një numër KZZ-sh nuk arriti t'i përmbahej afatit.

Gjatë raundit të parë, pasqyrimi i rezultateve ngjalli shqetësime serioze në një numër zonash. KZZ-ja e Zonës 40 e pranoi procesverbalin e rezultateve të një qendre votimi të paraqitur nga përfaqësuesi i PS-së, në vend të procesverbalit të rezultateve që gjendej në kutinë e votimit. KZZ-ja e Zonës 11 i paraqiti KQZ-së dy procesverbale nga zona, ku njëri tregonte fitoren në raundin e parë për PS-në dhe tjetri tregonte nevojën e një raundi të dytë. Procesverbale të kundërta për të njëjtën qendër votimi si dhe parregullsi të tjera ngjallin shqetësim në lidhje me pasqyrimin e rezultateve në zgjedhjet njëemërore në Zonat 19, 24, 25, 33, 40 dhe 67. Në secilin prej këtyre rasteve, procesverbalet e ndryshme, pasojë e manipulimit të procesverbaleve të KQV-ve, jepnin rezultate të ndryshuara. Procesverbali i rezultateve të KZZ-së në Zonën 33 nuk pasqyronte rezultatin e KQV-së 50 të regjistruar nga një vëzhgues i MVZ-së gjatë numërimit të votave.

Integriteti i rezultatit proporcional në shkallë vendi nga zgjedhjet e 24 qershorit ishte përgjithësisht i pranueshëm, megjithëse kishte disa raste që ngjallën shqetësim. BF-ja paraqiti procesverbale nga një numër i KQV-ve të Zonës 33, duke përfshirë një formular pasqyrimi të një KZZ-je që tregonte se sasi të vogla votash ishin transferuar në favor të PAD-së duke manipuluar me procesverbalet. Një përfaqësues i PS-së u ankua zyrtarisht se, në Zonën 13, votat për PS-në ishin rindarë në favor të PA-së. Formularët e pasqyrimin, për Zonën 13 mund të gjenden pranë KQZ-së dhe ndryshojnë nga ato të paraqitura në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me apelimin ndaj rezultatit të votimit më 24 qershor. Ndërkohë që faqja e parë e dokumentit të paraqitur në Gjykatën Kushtetuese nuk është plotësuar fare, faqja e parë e atij që pretendohet se është i njëjti dokument paraqitur KQZ-së është i plotësuar, por shifrat e pjesëmarrjes nuk kuadrojnë, në disa raste, në mënyrë domethënëse. Megjithatë, përmbajtja e faqeve të brendshme, duke përfshirë votat e partisë, të dokumenteve përkatëse është identike.

Në raundin e parë dhe të dytë, si PS-ja, ashtu dhe PD-ja shpallën para kohe “rezultatet e zgjedhjeve”, në një kohë që asnjë KZZ nuk kishte arritur të plotësonte pasqyrimin e rezultateve. Gjatë raundit të dytë në Zonat 35, 49, dhe 69 dhe raundit të tretë në Zonat 4, 40 dhe 49, KZZ-të ndërprejnë punën me mbërritjen e të gjitha kutive të votimit dhe rezultateve dhe e shtynë procesin e pasqyrimin të tyre.

#### **D. PËRSËRITJA E ZGJEDHJEVE PËR VOTIMIN PROPORCIONAL**

Pas raundit të parë, KQZ-ja vendosi të përsëriste më 8 korrik zgjedhjet për votimin proporcional në disa qendra votimi në gjashtë zona. Arsyetimi i KQZ-së ishte se zgjedhjet nuk ishin zhvilluar në këto qendra votimi më 24 qershor. Gjithashtu, KQZ-ja urdhëroi përsëritjen e zgjedhjeve në të gjitha qendrat e votimit në Zonën 60 (Lushnje), ku, për shkak të ndërprerjes nga policia më 23 qershor të shpërndarjes së materialeve zgjedhore, sipas udhëzimeve të zëvendëskryetarit socialist të KZZ-së për arsye që mbeten të paqarta, nuk u zhvilluan zgjedhjet më datën 24 qershor.

Në parim, zgjedhjet për votimin proporcional duhet të zhvillohen në një ditë të vetme votimi në mbarë vendin. Si pasojë e vendimit të KQZ-së, rreth 36 500 votuesve iu kërkua të votonin dy jave më vonë sesa bashkëshortet e tyre. PS-ja iu bëri thirrje përkrahësve të saj që të votonin për PBDNj-në, PAD-në dhe PA-në, me qëllim që të rrisnin shumën e votave të tyre në shkallë vendi mbi pragun zgjedhor ligjor prej 2,5% të nevojshëm për t'u përfaqësuar në Kuvend. Secila prej këtyre partive gjendej afër pragut pas raundit të parë të zgjedhjeve, por asnjëra nuk e kishte kaluar

atë. Tashmë KQZ-ja kishte shpallur rezultatet paraprake të pjesshme për votën e proporcionalit. Pra, pa shkelur aspak ligjin, PS-ja ia arriti të ndiqte një strategji, e cila, nëse do të ishte e suksesshme, do të ndryshonte në mënyrë domethënëse përbërjen e Kuvendit në favor të partnerëve të saj në ish-koalicionin qeverisës. Përveç kësaj, nëpërmjet përsëritjes së zgjedhjeve në Zonën 60, zgjedhësit në Lushnje ishin në gjendje të ushtronin një ndikim të shpërpjestuar mbi rezultatin e zgjedhjeve, meqë votat e tyre mund të përcaktonin nëse PBDNj-ja, PAD-ja dhe PA-ja do të mund të kishin anëtarë në Kuvend.

Këto rrethana çuan në një zgjedhje tepër të kontestuar në Zonën 60 më 8 korrik. Në ditën e zgjedhjeve, prania e procesverbaleve të dyshimta me origjinë të paqartë minuan besimin në integritetin e procesit. KZZ-ja në Zonën 60 nuk mundi të binte dakort për procesverbalin e rezultateve dhe, përfundimisht, ajo nuk arriti të përfundonte procesverbalin. Në vend të kësaj, më 11 korrik, KZZ-ja e Zonës 60 mori një vendim që pranonte pamundësinë “e shpalljes së rezultatit të dy llojeve të zgjedhjeve dhe që kërkonte nga KQZ-ja të përsëriste zgjedhjet në këtë zonë”.

Më 12 korrik, KZZ-ja e Zonës 60 dorëzoi disa materiale tek KQZ-ja, duke përfshirë disa procesverbale KQV-je me rezultate të votimit proporcional. Shumë prej tyre përmbanin emra të njëjtë ose të ngjashëm me anëtarët e KQV-së. Më 13 korrik, në një seancë të KQZ-së, përfaqësues të partive politike paraqitën pikëpamje dhe konkluzione rreth Zonës 60. BF-ja, PSD-ja dhe Partia Demokratike pretenduan se kishte patur parregullsi të ndryshme në Zonën 60 ditën e zgjedhjeve dhe në ditët që pasuan dhe ato kundërshtuan fuqimisht propozimin e KQZ-së që ajo vetë të bënte pasqyrimin e rezultateve. PSD-ja dorëzoi një ankesë me shkrim në KQZ-ja, sipas të cilës, përfaqësuesve të saj në KQV-të e Zonës 60 u ish in refuzuar kopje të procesverbaleve të KQV-së. Në kundërshtim me këtë, PBDNj-ja, PAD-ja dhe PA-ja paraqitën argumente në favor të propozimit të KQZ-së për të përpunuar rezultatet në bazë të të dhënave që dispononte.

Më 14 korrik, KQZ-ja, me një votë 5 pro dhe 2 kundër, vendosi (i) të abrogonte vendimin e 11 korrikut të KZZ-së për të zhvleftësuar rezultatet e votimit proporcional, (ii) të shkarkonte dhe kërkonte ndjekje penale për pesë anëtarë të KZZ-së dhe Sekretarin, dhe (iii) të fillonte vetë pasqyrimin e rezultateve.

Më 22 korrik, pas një debati të zgjatur, KQZ-ja filloi procesin e përllogaritjes të rezultit për Zonën 60, duke hapur kutitë e votimit, duke nxjerrë procesverbalet dhe duke mbledhur rezultatet individuale. KQZ-ja vendosi përsëritjen e zgjedhjeve në gjashtë qendra votimi për arsye të parregullsive, si dhe në dy qendra votimi ku zgjedhjet nuk ishin zhvilluar. Sipas dokumentave të KQZ-së, të cilat regjistronin materialet e gjetura në kuti, 25 kuti votimi nuk përmbanin procesverbalet e rezultateve për konkurrimin proporcional. KQZ-ja vërejti gjithashtu parregullsi të tjera të rënda. Këto përfshinë 27 kuti votimi të cilave u mungonte numri i qendrës së votimit përkatëse, kuti votimi të pavulosura, zarfa të hapura me fletë votimit të përdorura, lista votuesish si dhe fletë votimi të vlefshme që mungonin. Gjithësesi, KQZ-ja ishte e vendosur të shpallte një rezultat për këtë zonë, pra, përdori të gjitha procesverbalet që dispononte, duke përfshirë edhe ato të dyshimta dhe me një origjinë të paqartë për të përllogaritur një rezultat përfundimtar. Rezultati i zgjedhjeve për proporcionalin në këtë zonë i ngriti PBDNj-në, PAD-në, dhe PA-në mbi pragun 2,5% dhe i futi në Kuvend me nga tre vende secila. Gjatë debatimit për rezultatin proporcional të Zonës 60, opozita nuk paraqiti asnjë procesverbal të qendrave të votimit që përmbante rezultate të ndryshme nga ato të përdorura nga KQZ-ja për përllogaritjen e rezultatin përfundimtar.<sup>18</sup>

<sup>18</sup> BF-ja mund të kishte mbledhur procesverbale të rezultateve të qendrave të votimit nga përfaqësuesit e vet në KQV-të.

## E. RINUMËRIMI

Disa konkurrime në raundin e dytë u përcaktuan me diferencë të ngushtë, ku numri i fletëve të votimit të quajtura të pavlefshme, në disa raste, ishte më i madh sesa marzhi i fitores. Pas raundit të dytë, gjykatat e faktit në pesë zona filluan rinumërimin e fletëve të votimit, ashtu siç përcaktohet në Kodin Zgjedhor. Rezultatet në tri nga këto zona ngjallën shqetësime.

Në zonën 29, gjykata lokale e faktit nuk arriti të kontrollonte imtësisht fletët e votimit të shpallura të pavlefshme nga KQV-të, shpërfilli udhëzimin e KQZ-së se si duhet të përcaktohet vlefshmëria e fletës së votimit, si dhe shpërfilli dispozitat e nenit 106 të Kodit Zgjedhor për rinumërimin. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese nuk arriti të hetonte në mënyrë të mjaftueshme lidhur me këtë rast dhe, për pasojë, ka dyshime për rezultatin e zgjedhjeve. Përveç kësaj, njoftime të besueshme për një kërcënim nga një një deputet i PS-së ndaj një kandidati të BF-së nuk u hetuan plotësisht nga autoritetet.

Në Zonën 35, një rinumërim nga një gjykatë fakti përmbysi rezultatin fillestar. Niveli i sigurimit të materialit zgjedhor ishte i diskutueshëm, gjatë periudhës ndërmjet numërimit fillestar dhe numërimit nga ana e gjykatës. Në Zonën 36, rinumërimi nga një gjykatë fakti zvogëloi në mënyrë domethënëse kufirin e fitores për një kandidat të BF-së. Në këtë rast, një vëzhgues vërejti se kutitë e votimit ishin të çara. Nuk pati një rinumërim në Zonën 28, ku, më 8 korrik, vëzhguesit njoftuan për mbushje të kutive të votimit, ku kufiri i fitores për kandidatin socialist ishte 628 vota, me 412 vota të pavlefshme.

## ZHVILLIMET PAS 22 KORRIKUT ME PËRFUNDIMIN MVZ

Më 29 korrik, zgjedhjet u përsëritën në Zonën 13, pas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, në tetë qendra votimi të Zonës 60, tre qendra votimi në Zonën 4, dhe 17 qendra votimi në Zonën 21. OSBE/ODIHR-i nuk i monitoroi këto zgjedhje, por Prezenca e OSBE-së në Shqipëri bashkërendoi nëntë ekipe vëzhguesish të ofruar nga misionet të përhershme diplomatike, nga Misioni Monitorues i Bashkimit Evropian (MMBE), dhe nga Këshilli i Evropës. Zgjedhjet në Zonën 4 nuk u zhvilluan për arsye të divergjencave serioze ndërmjet përfaqësuesve partiakë në KZZ.<sup>19</sup> Pas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, ishte e nevojshme një ditë e pestë votimi, më 19 gusht, për të përfunduar votimin në Zonën 82 ku zgjedhjet u përsëritën në katër qendra votimi të diskutueshme.

Më ose pas 22 korrikut u zhvilluan dymbëdhjetë zgjedhje të plota apo të pjesshme, prej të cilave opozita vuri në pikëpyetje rezultatet në 8 zona.<sup>20</sup> OSBE/ODIHR-i ka shqetësime specifike në lidhje me mënyrën e zhvillimit të zgjedhjeve, ose me procesin e apelimit në Zonat 2, 13, 49 dhe në ashtu siç e kemi specifikuar më lart, Zona 60. Përveç kësaj, nuk u krye asnjë herë rinumërimi në Zonën 14 ashtu siç u kërkuar nga BF-ja, dhe në Zonën 18, ku BF-ja ngre pretendime për një sërë shkeljesh zgjedhore, që ndikuan në rezultatin përfundimtar.

<sup>19</sup> Anëtarët e KQV-së të caktuar nga partitë opozitare nuk arritën të merrnin pjesë më 29 korrik në përsëritjen e zgjedhjeve në Zonën 60. KQZ-ja vendosi mos-përsëritjen e zgjedhjeve në Zonën 4 dhe shpalli një rezultat përfundimtar në bazë të rezultateve ekzistuese të KQV-së, me kandidatin PD të deklaruar fitues.

<sup>20</sup> Zonat 2, 13, 14, 18, 49, 60, 82 dhe 86. Raporti BF-së “Zgjedhjet 2001 në Shqipëri Një Raport për Komunitetin Ndërkombëtar”, 27 gusht, 2001, përvijon pretendime për parregullsi dhe shkelje në përafërsisht 15 zona të tjera.

Në zhvillimet e tjera, Gjykata Kushtetuese ja dha mandatin për Zonën 35 PD-së, duke përmbysur një vendim të KQZ-së për t'ja dhënë mandatin një kandidati socialist. Në Zonën 82, Gjykata Kushtetuese përmbysi një vendim të KQZ-së për të deklaruar fitues kandidatin e BF-së (në bazë të rezultateve të pjesshme) dhe ajo urdhëroi përsëritje të zgjedhjeve në katër qendra votimi. Këto u zhvilluan në datën 19 gusht. Së fundi, kandidati i PS-së u deklarua fitues, duke siguruar një marzh jashtëzakonisht të ngushtë fitoreje.

## **XII. ANKESAT DHE APELIMET**

OSBE/ODIHR-i mori pothuajse 1000 ankesa me shkrim dhe me gojë si dhe njoftime për parregullsi nga partitë politike, kandidatët dhe anëtarët e komisioneve zgjedhore. OSBE/ODIHR-i hetoi shumë raste dhe zbuloi se shumica ishin të pambështetura në fakte të mjaftueshme. Megjithatë, disa raste të besueshme u apeluan në gjykata ose në KQZ. Vëllimi i ankesave ishte jashtëzakonisht i madh, duke treguar si natyrën polemike të konkurimit, ashtu edhe shkallën e përdorimit nga ana e partive të mekanizmave ligjore të disponueshëm për të kërkuar zgjidhje. Megjithatë, për disa çështje të rëndësishme, partitë politike nuk i apeluan vendimet e KQZ-së.

### **A. TRAJTIMI NGA KQZ-JA I ANKESAVE DHE APELIMEVE PASZGJEDHORE**

Pas raundit të parë, partitë politike kundërshtuan shpesh rezultatet e zonave dhe depozituan një numër të madh ankesash pranë komisioneve zgjedhore dhe gjykatave. Në disa raste, procedura e ankesave zgjedhore nuk ofroi mjete efikase zgjidhjeje dhe në shumë raste, KQZ-ja preferoi të mos hetonte plotësisht akuzat mbi parregullsi serioze dhe mashtrim, duke përfshirë parregullsi kaq serioze, si procesverbale të ndryshme për të njëjtën qendër votimi. KQZ-ja pretendon se ajo nuk ka fuqinë dhe mjetet e mjaftueshme për të zhvilluar hetime të rregullta. Për arsye të paaftësisë së KQZ-së për të hetuar parregullsitë deri në fund, deri më 8 korrik, shumë raste prisnin për t'u gjykuar në gjykata të ndryshme, duke krijuar pasiguri se në cilat zona do të zhvillohej raund i dytë.

Disa zona ku u pretenduan ose u vëzhguan parregullsi përfshinin elektorate të ndjeshme politikisht ku kandidonin politikanë të sprovuar. KQZ-ja ishte e përçarë për disa nga këto raste tepër të debatuar dhe duket se ra nën një trysni politike të pamerituar, që çoi në akuza të besueshme se disa mandate nuk u ndanë në mënyrë të drejtë apo korrekte dhe se disa konkurrime të raundit të dytë që duhet të zhvilloheshin u shmangën.

Në dy raste, KQZ-ja u takua me anëtarët e KZZ-së me dyer të mbyllura, në kundërshtim të hapur me Kodin Zgjedhor. Në disa raste rezultatet që vinin nga zonat e diskutueshme përcaktoheshin gjatë seancave të KQZ-së gjatë orëve të vona të natës, duke ndikuar negativisht mbi transparencën e procesit.

Mënyra e trajtimit të ankesave nga KQZ-ja u përmirësua pas raundit të dytë. Veçanërisht, KQZ-ja u angazhua më tepër në hetimin e akuzave për parregullsi dhe mashtrim. Në çështjet e debatueshme, përgjithësisht KQZ-ja u konsultua me KZZ-në e zonës përkatëse. Pra, KQZ-ja ishte më mirë e informuar për çështjet përkatëse. Megjithatë, KQZ-ja ishte e përçarë në shumicën e këtyre rasteve dhe vendimet e saj u apeluan në Gjykatën Kushtetuese.

### **B. TRAJTIMI I NGA GJYKATAT I ANKESAVE DHE APELIMEVE PASZGJEDHORE**

Pas zgjedhjeve të 24 qershorit, u depozituan 28 raste në Gjykatën Kushtetuese, vetëm 12 prej të cilave u zgjidhën gjatë raundit të dytë më 8 korrik. Pas raundit të dytë, u depozituan nëntë çështje të tjera. Në shumë raste, Gjykata vendosi përfundimisht mbi rezultatet e zgjedhjeve. Megjithatë, vendimet e Gjykatës nuk bazoheshin gjithmonë mbi standarte të përcaktuara qartë ose të zbatuara në mënyrë konsekuente. Për shembull, në raste në dukje të ngjashme, Gjykata Kushtetuese vendosi zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve në Zonat 25 dhe 40, por jo në Zonat 19, 24, 57, 63, dhe 67.<sup>21</sup>

Në disa raste, u duk se Gjykatat nuk arritën të hetonin në mënyrë të mjaftueshme ose të merrnin plotësisht parasysh rrethanat ose faktet e paraqitura. Për shembull, në Zonën 19, Gjykata Kushtetuese deklaroi se “të dyja pasqyrat e rezultateve ishin të nënshkruara nga të njëjtët anëtarë të komisionit...”, kurse kopjet e të dyja versioneve të procesverbalit të manipuluar të KQV-së 6, Zona 19, që ju shpërndanë vëzhguesve në orët e para të 25 qershorit, treguan qartësisht të kundërtën. Gjykata Kushtetuese preferoi të mbështetej jo në procesverbalet e përgatitura në qendrën e votimit nga KQV-ja, por në të kundërt vendosi të rinumërojë fletët e votimit të cilat, ndoshta, mund të mos ishin ruajtur të paprekura në mënyrë të mjaftueshme përpara gjykimit të çështjes. Megjithatë, nuk kishte procesverbal në kutinë e votimit dhe zarfat e sigurisë ishin të hapura.

Transparenca e seancave të gjykimit ishte ndonjëherë problematike. Për shembull, OSBE/ODIHR-i nuk arriti të marrë në kohë dokumentacionin e plotë në lidhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese për të përsëritur zgjedhjet në Zonën 13, ku fitorja e raundit të parë të kandidatit të BF-së dukej bindëse.

Një element njëanshmërie dukej se po ravijëzohej në disa vendime, për shembull, në Zonat 19, 24 dhe 67. Pati njoftime për parregullsira mjaft serioze në Zonën 25 më 24 qershor dhe përsëri më 8 korrik. Fakti se gjykatat nuk arritën të zgjidhnin ankesat e paraqitura përpara raundit të dytë dhe se kryetari i ri i KZZ-së në Zonën 25 (i caktuar tre ditë përpara raundit të dytë) është një i afërm i ngushtë i fituesit eventual, ngrajnë dyshime serioze përsa i përket besueshmërisë së procesit në Zonën 25. Megjithatë, pas raundit të dytë, kandidati humbës preferoi të mos kërkojë zgjidhje të mëtejshme.

### **XIII. REZULTATET**

Pas zgjedhjeve të 24 qershorit, KQZ-ja shpalli se ishin zgjedhur 31 kandidatë të PS-së, 16 kandidatë të BF-së, dhe një kandidat të pavarur, Llesh Zef Kola (në Zonën 13). Në dyzet e pesë zona kishte nevojë për një raund të dytë zgjedhjesh sepse asnjë prej kandidatëve nuk arriti të merrte më shumë se 50% të votave dhe ishte e nevojshme që në shtatë zona të përsëritej pjesërisht apo plotësisht raundi i parë për shkak të parregullsive. Megjithatë, u apeluan në Gjykatën Kushtetuese 28 vendime të KQZ-së lidhur me rezultatet e raundit të parë. Gjykata shpalli vendimin e saj të fundit për këto zona më 17 korrik, duke përmbysur ose abroguar pjesërisht 7 vendime të KQZ-së. Pra, pas përfundimit të procesit të gjykimit për mosmarrëveshjet e raundit të parë, PS-ja kishte fituar 32 vende dhe koalicioni i BF-së kishte fituar 15 vende në votimin njëëmëror.

Në raundin e dytë, pas përfundimit të rinumërimit të fletëve të votimit nga gjykatat e faktit, PS-ja kishte fituar 67 mandate dhe BF-ja 21 mandate. Një kandidat i pavarur, Agron Duka u zgjodh në

<sup>21</sup> Raporti Përfundimtar i nxjerrë më 11 Tetor 2001 citonte se Gjykata Kushtetuese vendosi gjithashtu që të zhvillohej raundi i dytë në Zonën 33. Ky fakt nuk ishte i vërtetë. Në të vërtetë ishte KQZ-ja ajo që vendosi të zhvillohej raundi i dytë në atë Zonë.

Zonën 25, ku vëzhguesit verifikuan raste mashtrimi. Pas votimit të 22 korrikut, 29 korrikut, 19 gushtit, PS-ja fitoi 73 vende, BF-ja 25 vende dhe u zgjodhën dy kandidatë të pavarur.

Më 12 gusht, KQZ-ja shpalli që, nga të 40 mandatet “plotësuese”, BF-së do t’i jepeshin 21 vende, Partisë Demokratike 6 vende, PSD-së 4 vende, PBDNJ-së 3 vende, PA-së 3 vende dhe PAD-së 3 vende.<sup>22</sup> Pra, të marra së bashku, BF-ja fitoi 46 vende.

Fitorja e PS-së në këto zgjedhje nuk u vu në diskutim, por vetëm thellësia e kësaj fitoreje u vu në pikëpyetje.

#### **XIV. REKOMANDIME**

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 u pa se PS-ja fitoi vende të mjaftueshme për të formuar qeverinë e ardhshme dhe se opozita doli më mirë se sa pritej. Gjithashtu, në këto zgjedhje u vërejtën parregullsi serioze në një numër të kufizuar zonash si edhe shqetësime institucionale që i duhen dhënë zgjidhje. Këto parregullsi serioze erdhën më tepër si pasojë e mungesës së vullnetit politik se sa e boshllëqeve teknike në Kodin Zgjedhor. Rekomandimet që vijojnë sugjerojnë zgjidhjet e mundshme. Përveç kësaj, nuk është ezauruar ende procesi ligjor. Kandidatët që kanë ankesa, si dhe partitë politike me fakte mbi parregullsitë, duhet të përdorin procesin ligjor dhe të kërkojnë zgjidhje të mëtejshme, duke përfshirë edhe Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut në Strasbourg.

Megjithë kritikën e përfshirë në këtë raport, tani është e nevojshme të hedhim vështrimin përpara. OSBE/ODIHR-i do të mirëpriste një lëvizje nga partitë politike në Shqipëri për ta çuar më tej shqyrtimin mbi zhvillimet dhe shkeljet gjatë këtyre zgjedhjeve, duke patur parasysh identifikimin e recetave politike dhe fillimin e diskutimeve rreth rishikimit të kuadrit zgjedhor. Një komision parlamentar bi-partisan, i cili gjithashtu mund të merrte parasysh rekomandimet e mëposhtme, do të mund të ishte një mjet për të arritur këtë qëllim.

##### **A. KUADRI LIGJOR**

1. Sistemi zgjedhor kërkon thjeshtësim dhe reformim dhe duhet të rishqyrtohet me synimin e futjes së një sistemi, që të mundësojë zhvillimin e zgjedhjeve në një ditë të vetme në të gjithë vendin.
2. Kodi Zgjedhor duhet rishikuar në një sërë ose në një numër aspektesh kyçe, duke përfshirë heqjen e përgjithshme të dispozitave për votuesit me vendqëndrim të përkohshëm, kalendarin zgjedhor për të bërë dallimin midis fazave të ndryshme të procesit, fizibilitetin për përsëritjen e zgjedhjeve, transparencën dhe pasqyrimin e rezultateteve.
3. Të gjitha afatet duhet të përcaktohen qartësisht në Kodin Zgjedhor.
4. Duhet të qartësohen dispozitat për një rinumërim të fletëve të votimit dhe duhet të forcohet transparenca.
5. Duhet të ketë një dallim të qartë ndërmjet formularëve të procesverbaleve që përdoren nga administrata zgjedhore për të pasqyruar rezultatet dhe formularëve të procesverbaleve përkatëse të cilat u jepen partive dhe kandidatëve, për shembull, pasqyrimi zyrtar i rezultateve duhet të

<sup>22</sup> Vendimi i KQZ-së nr. 227, 21 gusht 2001.



bëhet vetëm në bazë të formularëve 54 dhe 55, ndërsa formulari 56 duhet të jetë i vetmi formular që u jepet përfaqësuesve partiakë dhe vëzhguesve. Megjithatë, formulari 56 duhet nënshkruar dhe vulosur në mënyrë që të përdoret si provë nga gjykatat.

6. Procedura për pasqyrimin e rezultateve zgjedhore të konsoliduara nga KQZ-ja kërkon një detajim më të madh, në mënyrë të veçantë, KQZ-ja duhet të marrë një kopje të çdo procesverbali të KQV-së bashkëngjitur formularëve të rezultateve të KZZ-së, si edhe procesverbalin e KZZ-së.
7. Afati për regjistrimin e kandidatëve duhet të zhvendoset në një datë përpara fillimit të fushatës. Kjo do të qartësonte se kush cilësohen si kandidatë në kohën kur fillon fushata, dhe në këtë mënyrë rritet transparenca. Gjithashtu, kjo do t'i japë më shumë kohë KQZ-së për të organizuar zgjedhjet.
8. Kuadri kohor për të bërë apelimet zgjedhore duhet rishikuar për të shmangur fragmentimin e procesit zgjedhor.
9. Procesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore mund të rishikohet në përputhje me udhëzimet e hartuara nga OSBE/ODIHR-i për ta bërë më të qartë procesin e apelimet zgjedhor, duke e përqëndruar vëmendjen kryesisht në rolet përkatëse të komisioneve zgjedhore dhe të gjykatave.<sup>23</sup> Afatet për gjykimin e ankesave dhe të apelimëve duhen specifikuar. Duhet të sqarohen qartësisht se cilat janë kompetencat investiguese të KQZ-së.

## **B. ADMINISTRATA ZGJEDHORE**

1. Partitë politike duhet të vazhdojnë të kenë përfaqësues në komisionet zgjedhore për të ngjallur besim në proces.
2. Anëtarët e KZZ-ve nuk duhet të kenë marrëdhënie familjare apo biznesi me një kandidat për të shmangur konfliktin e interesave.
3. KZZ-të duhet të marrin burime të përshtatshme duke përfshirë së paku një hapësirë pune të mjaftueshme, një mjedis të sigurtë, një linjë faksi dhe telefoni në gjendje pune.
4. Si KZZ-të, ashtu edhe KQV-të duhet të marrin në kohë dhe në mënyrë të vazhdueshme trajnim për të përmirësuar zbatimin e procedurave, në mënyrë të veçantë në lidhje me numërimin dhe ruajtjen e fshehtësisë e votës.
5. Duhet të përdoren kuti më të sigurtë votimi për të bërë të pamundur ndërhyrjen në materialet që gjenden brenda tyre pas fillimit të votimit.
6. Duhet të mbahet një regjistër i numrave serial të procesverbaleve të KQV-ve dhe KZZ-ve, të shpërndara me një numër të veçantë, unik dhe lehtësisht të identifikueshëm që i bashkëngjitet protokollit, i cili do të vendoset në kutinë e votimit. Vetëm ato protokolle që gjenden brenda në kutinë e votimit përdoren për të përlogaritur rezultatin nga KZZ-ja Megjithatë, kopjet që u jepen anëtarëve të KQV-së mund të përdoren për t'i paraqitur një ankesë KZZ-së, KQZ-së ose gjykatës. Këto duhet të merren parasysh në çdo rast gjykimi.

<sup>23</sup> Shih "Resolving Election Disputes in the OSCE Area: Towards a Standard Election Dispute Monitoring System", OSCE/ODIHR Warsaw, 12 July 2000.

7. Duhet të përmirësohet saktësia e listës së votuesve.
8. Duhet të paraqitet një sistem mbarëkombëtar i unifikuar për të numëruar qendrat e votimit.

### **C. MEDIA DHE FUSHATA**

1. Ligji për median dhe rregullimet duhet të interpretohen dhe të zbatohen në mënyrë të drejtë, veçanërisht në lidhje me çështje të tilla si: keqpërdorimi i shtypit, shkelja e etikës profesionale, e drejta e replikës.
2. Duhet të zbatohen në mënyrë efikase rregullimet për të garantuar akses të lirë, të barabartë dhe të drejtë në media.
3. Kërkesa për paanshmëri si nga media elektronike private dhe publike, ashtu siç përcaktohet në Kodin Zgjedhor dhe në Kujtesën për pasqyrimin ligjor, profesional dhe etik të fushtatës zgjedhore,<sup>24</sup> si për median publike dhe atë private, duhet të respektohet plotësisht, veçanërisht nga transmetuesi publik, i cili ka detyrën për të ofruar informacion të paanshëm dhe të ekuilibruar për publikun.
4. Duhet të ruhet heshtja zgjedhore nga të gjitha partitë politike ashtu edhe nga media.
5. Legjislacioni në fuqi mbi financimin e fushatës duhet amenduar për të pakësuar përparësinë e jashtëzakonshme që u jepet partive të mëdha dhe për të siguruar se partitë e vogla kanë fonde të mjaftueshme për të blerë një kohë televizive minimale për spote zgjedhore në kanalet private.

### **D. PJESËMARRJA E GRAVE NË PROCESIN ZGJEDHOR**

Partitë politike duhet të marrin parasysh masa për të nxitur një pjesëmarrje më të madhe të grave në zgjedhje. Kjo duhet të përfshijë një transparencë më të madhe në përzgjedhjen e kandidatëve; masa të veçanta për të rritur numrin e kandidatëve femra në pozicionet më të larta në lista; dhe duke rritur numrin e grave në komisionet qendrore dhe vendore.

Trajnimi i anëtarëve të KQV-së duhet të bëhet për të nxjerrë në pah faktin se votimi në grup nuk duhet lejuar. Programet e edukimit të zgjedhësve duhet t'u shpjegojnë grave rëndësinë e zgjedhjes personale kur votojnë.

---

<sup>24</sup> Nr. 253 Prot, publikuar nga KKRT-ja në 26 prill 2001.